



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
AGJENCIA E MBIKËQYRJES POLICORE

Nr. 19/40 Prot.

Tiranë më, 03/05/2024

V E N D I M

PËR SUBJEKTIN E VLËRËSIMIT Z. FATMIR LLESHAJ

Nr. 21, datë 05.04.2024

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e përbërë nga:

Erjana Pjetri
Klevis Dhigoi
Ersa Karaj

Relatore
Kryesues
Anëtare

Asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga anëtarja e Sekretariatit Teknik, znj. Lediana Azemaj, më datë 05.04.2024, ora 10:00, në ambientet e Ministrisë së Brendshme, mori në shqyrtim mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket:

SUBJEKTIT TË VLËRËSIMIT: **Fatmir Preng Lleshaj**, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Drejtimit, në Departamentin e Sigurisë Publike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

OBJEKTI: Vlerësimi kalimtar i subjektit të vlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Ligji nr. 12/2018**, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

Ligji nr. 49/2012, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”, i ndryshuar.

Rregullore Nr. 197, datë 28.02.2023, “Për hapat proceduralë të unifikuar”.

TRUPA E VLERËSIMIT TË AGJENCISË SË MBIKËQYRJES POLICORE,

pasi dëgjoji gjetjet dhe rekomandimin e relatores së çështjes Erjana Pjetri, vlerësoi shpjegimet e subjektit të vlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit; pasi dëgjoji subjektin e vlerësimit Fatmir Lleshaj, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë; pasi shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi duke u bazuar në të tre kriteret e vlerësimit, të pasurisë, të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të Ligjit nr. 12/2018 të ndryshuar,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Agjencia e Mbrojtjes Policore është institucioni që kryen procesin e vlerësimit kalimtar të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbrojtjes Policore, bazuar në Ligjin 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar.
2. Sipas përcaktimeve të nenit 6, të Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, shtetasi Fatmir Lleshaj, është subjekt i vlerësimit kalimtar nga Trupat e Vlerësimit të Agjencisë së Mbrojtjes Policore, për shkak të funksionit të tij në datën e zhvillimit të shortit (05.04.2023), si Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Drejtimit, në Departamentin e Sigurisë Publike pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
3. Subjekti i vlerësimit, z. Fatmir Lleshaj, iu nënshtrua procedurave të vlerësimit, duke u shortuar në shortin e zhvilluar më datë 05.04.2023, nga Trupat e Vlerësimit në përputhje me Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit”, për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”.
4. Në zbatim të legjislacionit në fuqi mbi parandalimin e konfliktit të interesit, me vendimin Nr. 01, datë 18.04.2023, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupës së vlerësimit e përbërë nga: z. Klevis Dhigoi (Kryesues), znj. Erjana Pjetri (Relatore) dhe znj. Ersa Karaj (Anëtare).
5. Trupa e Vlerësimit, në përputhje me Ligjin nr.12/2018, i ndryshuar, si edhe në bazë të Rregullores nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar” me Vendimin Nr. 22/2 prot., datë 18.04.2023, vendosi fillimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit Fatmir Preng Lleshaj.

6. Relatorja e çështjes, znj. Erjana Pjetri, nëpërmjet komunikimit elektronik zyrtar datë 18.04.2023, ka njoftuar subjektin e vlerësimit për fillimin e procesit të vlerësimit kalimtar, dhe i është bërë e njohur përbërja e Trupës së Vlerësimit, duke i kërkuar subjektit të vlerësimit të deklarojë nëse është në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupës së vlerësimit.
7. Subjekti i vlerësimit ka dorëzuar deklaratën për konfliktin e interesit në Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore më datë 20.04.2023, duke shprehur se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me asnjë nga anëtarët e Trupës së Vlerësimit.
8. Relatorja e çështjes në vijim ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 3 të nenit 25, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, duke kryer një hetim të plotë mbi tre kriteret e vlerësimit kalimtar.
9. Në vijim të procesit për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Lleshaj, mbështetur në nenin 33/1, nenin 42 dhe nenin 46, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, relatorja e çështjes ka dërguar pranë institucioneve ndihmëse, si më poshtë vijon:
 - Formularin e deklaramit të pasurisë dhe dokumentacioni shoqërues, me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 19.04.2023, pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI).
 - Formularin e Vlerësimit të Aftësive Profesionale me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 19.04.2023, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
 - Formularin e Kontrollit të Figurës, me shkresë përcjellëse Nr. *** Prot., datë 19.04.2023, pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.
10. Për të realizuar procedurat e vlerësimit kalimtar të punonjësve, Trupa e Vlerësimit është bazuar në parimin e ligjshmërisë, të barazisë përpara ligjit dhe të proporcionalitetit, duke garantuar të drejtën e punonjësve për një proces të rregullt ligjor.
11. Procesi i vlerësimit kalimtar të punonjësve, bazuar në nenin 4, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, ka për objekt:
 - Vlerësimin e pasurisë;
 - Kontrollin e figurës;
 - Vlerësimin e aftësive profesionale.
12. Trupa e Vlerësimit ka realizuar procesin e hetimit administrativ, bazuar në:
 - a. Ligjin nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar;
 - b. Ligjin nr. 128/2021, “Për Agjencinë e Mbikëqyrjes Policore”;
 - c. Ligjin nr. 40/2015, “Kodi i Procedurës Administrative”;

- d. Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”;
- e. Udhëzimin e Ministrit të Brendshëm Nr. 07, datë 17.01.2023, “Për procedurat dhe mënyrat e hedhjes së shortit për trupat e vlerësimit dhe subjektet e vlerësimit të Ligjit 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, i ndryshuar”;
- f. Udhëzimin e përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe ILDKPKI-së Nr.15, datë 27.01.2023, “Për miratimin e formularëve të deklarimit të pasurisë për vlerësimin kalimtar dhe periodik, si edhe mënyrën e plotësimit të tyre nga subjektet e vlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklarimin e pasurisë në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar”;
- g. Rregulloren nr. 197, datë 23.02.2023, “Për hapat procedural të unifikuar”.

13. Gjithashtu, Trupa e Vlerësimit ka verifikuar dhe vlerësuar të gjitha faktet e rrethanat e nevojshme dhe konkretisht:

- ❖ *Deklaratën e Pasurisë;*
- ❖ *Deklaratën për Kontrollin e Figurës;*
- ❖ *Formularin e Vlerësimit Profesional;*
- ❖ *Dokumentacionin bashkëlidhur deklaratave për të justifikuar deklaratimet;*
- ❖ *Aktin e përfundimit të vlerësimit të pasurisë, nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave;*
- ❖ *Raportin mbi vlerësimin e aftësive profesionale, nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;*
- ❖ *Raportin mbi Kontrollin e Figurës, nga Agjencia e Mbikëqyrjes Policore;*
- ❖ *Provat shkresore/dokumente të administruara nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar;*
- ❖ *Provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të vlerësimit;*
- ❖ *Bashkëpunimin, gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit gjatë procesit të vlerësimit.*

14. Trupa e Vlerësimit, më datë 14.02.2024, pasi dëgjoi relatorin, dhe pasi krijoi bindjen se provat e administruara për kriterin e pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, kishin nivelin e provueshmërisë, si dhe pasi konstatoi se janë marrë të gjitha hapat e nevojshme për përfundimin e hetimit kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Lleshaj, me Vendimin Nr. 3, datë 14.02.2024, vendosi:

- a. Të mbyllë hetimin kryesisht për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Lleshaj;
- b. Të njoftojë me rrugë elektronike zyrtare subjektin për:
 - *Përfundimin e procedurave të hetimit kryesisht;*
 - *Rezultatet e hetimit të pasqyruara në relacionin paraprak për të tre komponentët; vlerësimin pasuror, kontrollin e figurës dhe atë profesional.*
- c. Të ftojë subjektin për t’u njohur me dosjen dhe provat e administruara nga Trupa e Vlerësimit, në përputhje me nenin 50, të Ligjit nr. 12/2018 i ndryshuar, nenet 35-40 dhe

45-47, të Kodit të Procedurës Administrative, duke i dhënë kohë të arsyeshme për t'u njohur me dosjen dhe për të paraqitur shpjegime.

15. Hetimi administrativ përfshiu edhe personat e lidhur apo persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pikat 12 dhe 14, të Ligjit nr.12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, si dhe nenit 3, pika 11 dhe nenit 5, të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në Ushtrimin e Funksioneve Publike”.

II. SEANCA DËGJIMORE

16. Seanca dëgjimore për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Lleshaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative, në datë 28.02.2024 në ambientet e Ministrisë së Brendshme, salla e mbledhjeve, Tiranë.

17. Në këtë seancë subjekti i vlerësimit u paraqit dhe u mbrojt personalisht, si dhe shprehu opinionin e tij në lidhje me procesin e vlerësimit të kryer duke kërkuar konfirmimin në detyrë.

18. Trupa e Vlerësimit zhvilloi seancën e dhënies së vendimit më datë 05.04.2024.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË VLERËSIMIT

19. Subjekti i vlerësimi z. Fatmir Preng Lleshaj, ka qenë bashkëpunues dhe korrekt gjatë gjithë procesit të vlerësimit në përputhje me pikën 2, të nenit 48, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

20. Subjekti ka paraqitur që në fazën e dorëzimit të deklaratave dokumentacion shoqërues të vlerësuar nga ana e tij, si dhe gjatë fazës së hetimit administrativ, gjatë komunikimit dhe pyetjeve të drejtuara nga relatorja, është përgjigjur dhe ka përcjellë dokumentacion shoqërues/justifikues shtesë, me qëllim vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, sipas rastit dhe rrethanave të tjera të çështjes për sqarim, i kërkuar nga ana e relatores.

IV. PROCESI I VLERËSIMIT NGA TRUPA E VLERËSIMIT

A. VLERËSIMI I PASURISË

21. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e vlerësimit, në përputhje me kreun III, “Vlerësimi i pasurisë”, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, e veçanërisht në nenin 31 të këtij Ligji, ka për objekt deklarimin dhe kontrollin e pasurive, ligjshmërinë e burimit të krijimit të tyre dhe përmbushjen e detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e vlerësimit kalimtar dhe për personat e lidhur me të.

- 22.** Në zbatim të nenit 32, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat”, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit z. Fatmir Lleshaj ka dorëzuar deklaratën e pasurisë më datë 09.03.2023. Formulari i Pasurisë ka Nr. Indeksi 21, datë 09.03.2023.
- 23.** Procedurat e deklaramit të pasurisë kryhen sipas përcaktimeve të nenit 32 dhe 33, ndërsa vlerësimi i pasurisë nga Trupa e Vlerësimit kryhet sipas përcaktimeve të nenit 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- 24.** Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara dhe mjaftueshmërisë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, janë kryer verifikime në institucionet apo personat juridikë, publikë apo privatë.
- 25.** Trupa e Vlerësimit hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKIsë, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
- 26.** Gjithashtu, ka kontrolluar dhe krahasuar gjendjen pasurore dhe ndryshimet e saj në vite, burimin e krijimit, shlyerjen e detyrimeve financiare, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e vlerësimit dhe personave të lidhur me të.

27. Trupa e Vlerësimit për realizimin e procesit të vlerësimit të pasurisë administroi:

- Deklaratën e pasurisë dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- Deklaratat e interesave private për të gjithë periudhën që ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së.
- Raportin e hollësishëm të përgatitur nga ILDKPKI në zbatim të neneve 33/1 dhe 34, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Provat shkresore/dokumente të vëna në dispozicion nga institucionet/organet publike dhe private në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar.
- Shpjegimet e subjektit për burimin e të ardhurave, mbulimin e shpenzimeve dhe të detyrimeve financiare.
- Dokumentacionin e paraqitur në deklaramet e subjektit, si përgjigje të pyetjeve të dërguara nëpërmjet postës elektronike.

28. Hetimi administrativ i kryer nga Trupa e Vlerësimit konsistoi në:

- Verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të deklaruar nga subjekti i vlerësimit.
- Verifikimin e burimit/eve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të deklaruara si edhe në mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet financiare të ligjshme.

- Evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi apo në përdorim.
- Evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme si edhe evidentimit të rasteve të konfliktit të interesit.

29. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja:

29.1 Fatmir Lleshaj është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2011 dhe ka dorëzuar ndër vite deklaratat e interesave private, si më poshtë:

- Para fillimit të detyrës 2011
- Periodike/Vjetore 2011
- Pas largimit nga funksioni 2012
- Para fillimit të detyrës 2013
- Periodike/Vjetore 2014
- Periodike/Vjetore 2015
- Periodike/Vjetore 2016
- Pas Largimit nga Funksioni 2017
- Para fillimit të detyrës 2020
- Periodike/Vjetore 2020
- Periodike/Vjetore 2021
- Periodike/Vjetore 2022

29.2 ILDKPKI, në përputhje me Ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publik”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, Ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesave”, i ndryshuar, si dhe Kodin e Procedurave Administrative; ka dërguar raport të hollësishëm nr. *** prot., datë 03.10.2023, bazuar në dokumentacionin e administruar, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Lleshaj, ku është konstatuar se:

- a) deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare;
- b) nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c) nuk është kryer fshehje e pasurisë;
- d) nuk është kryer deklarim i rremë;
- e) subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.

DEKLARIMI I PASURIVE NGA SUBJEKTI I VLERËSIMIT, FATMIR LLESHAJ

Pasuria Nr. 1

Apartament, me sipërfaqe 142.3 m², nr. pasurie ***, ndodhur në Tiranë, Njësia Administrative Nr. 5, Ndërtesa nr. *, data e blerjes 01.01.1998. vlera 1.100.000 lekë. Shuma e shpenzimeve për rregullimin dhe

akomodimin rreth 1.500.000 lekë. Është blerë me kontratë besimi në vitin 1997. **Pjesa takuese:** 100%. **Burimi i krijimit:** Të ardhurat nga paga, shërbimet, shpërblimet, të ardhurat nga prindërit dhe familjarët.

➤ ***Bashkëlidhur deklaratës:***

1. Certifikatë për vërtetim pronësie nr. ****, datë 17.05.2017, për apartamentin me sip. 142.3 m², ndodhur në Tiranë, në pronësi të Fatmir Lleshaj.
2. Leje legalizimi nr. ****, datë 02.08.2013, shtesë anësore 7 kat në objektin ekzistues, i jepet: “S. P + banorët”, zona kadastrale 8260, sip. parcele 129.2 m², sip. ndërtimi 121.3, sip. totale 987.6 m². Titulli i pronësisë mbi tokën i vërtetuar me dokumentin: kontratë kalimi pronësie të parcelës ndërtimore Nr. **** Rep. Nr. **** Kol, datë 31.07.2013, në bazë të VKM nr. 359, datë 04.05.2011.
3. Shkresë nr. *** prot, datë 19.06.2013, nga ALUIZNI, drejtuar: “S. P + banorët”, dërgohet formulari i pagesës së parcelës ndërtimore “Shtesë anësore pallati”, nr. **, vetëdeklarim nr. **/Prot., datë 28.08.2006. Referuar shkresës, përcaktohen detyrimet e secilit prej banorëve, ku vlera përkatëse e Fatmir Lleshaj është në shumën 151.592 lekë.

HETIMI ADMINISTRATIV

30. Për të vërtetuar saktësinë e vlerësimit të pasurisë së deklaruar, saktësinë e burimeve financiare të deklaruara, mjaftueshmërinë e mbulimit të pasurisë nga burimet e deklaruara, si dhe evidentimin e rasteve të konfliktit të interesit, ILDKPKI dhe Agjencia e Mbikëqyrjes Policore, u kanë kërkuar informacion Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Regjistrat Noterial, FSHU, 14 Shoqërive Rajonale Ujësjellës – Kanalizime, institucioneve bankare dhe jo-bankare, si dhe u janë drejtuar vetë subjektit. Nga përgjigjet e administruara dhe të analizuara, rezultoi se:

31. ASHK Tirana Jug, me shkresën nr. *** prot., datë 26.06.2023, konfirmon pasurinë nr. ****, zk 8260, regjistruar në emër të Fatmir Preng Lleshaj, me leje legalizimi.

➤ ***Bashkëlidhur ndodhet:***

1. Kartela e pasurisë së paluajtshme e llojit apartament me sipërfaqe 142.3 m², me Tiranë, në pronësi të Fatmir Lleshaj.
2. Kontratë kalimi pronësie të parcelës ndërtimore nr. **** rep., nr. **** kol., datë 31.07.2013, me palë shitëse Drejtoria e ALUIZN-it Tirana 3 dhe palë blerëse shtetasit Q. C, S. P, D. D, L. Xh, Fatmir Lleshaj, A. H, M. Z. Objekt i kësaj kontrate është kalimi në pronësi i pjesës takuese në bazë të VKM-së nr. 359, datë 04.05.2011. Shitësi i kalon të drejtën e pronësisë mbi këtë sipërfaqe toke blerësit, pasi të ketë paguar vlerat e taksës së ndikimit në infrastrukturë 553.445 lekë dhe parcelës ndërtimore 1.056.857 lekë. B/lidhur ndodhen formularët e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale (pjesa takuese e Fatmir Lleshaj në shumën 78.091 lekë), si dhe e parcelës ndërtimore (pjesa takuese e Fatmir Lleshaj në shumën 151.592 lekë).

31.1 Në proces-verbalin e datës 27.07.2023, subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me pasurinë e sipërcituar, konkretisht:

*“...Banorët e ndërtesës nr. *, Hyrja nr. *, në Rrugën “Nuçi Naçi”, së bashku kanë ndërtuar një shtesë në krahë të hyrjes së tyre me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 129.2 m², me numër të kateve mbi tokë 7, specifikuar kjo edhe në vetëdeklarimin për legalizimin e shtesës anësore 7 kate pranë objektit ekzistues 6 kate, në datë 28.07.2006.*

*Si rrjedhojë e këtij ndërtimi banorët e shkallës nr. 5, kanë përfitur nga një apartament me sipërfaqe 142.3 m² (bashkë me sipërfaqen e përbashkët). Nga banorët e ndërtesës nr. **, hyrja nr. *, janë shitur 6 nga 7 apartamentet e përfitur nga shtesa e ndërtuar në mënyrë informale dhe vetëm njëri nga banorët e përdor vetë. Babai i tij Preng Lleshaj ka blerë njërin nga këto apartamente i përfitur nga ndërtimi informal dhe pikërisht shtetasit H. H, që ka qenë një nga banorët e hyrjes ekzistuese. Apartamentin e ka blerë në ndërtim e sipër, në momentin kur ndërtimi informal (shtesa), ishte në fazën e ndërtimit karabina (kollona) në vitin 1998. Punimet e tjera për ta përshtatur për banim janë bërë nga ai, babai dhe familjarët e tij. Pasi kanë përfunduar punimet , rreth vitit 2002, babai e ka autorizuar ta vetëdeklarojë për legalizim dhe më vonë për ta hipotekuar në emrin e tij. Apartamenti është vetëdeklaruar si ndërtim pa leje, më datë 28.07.2006, legalizuar datë 02.08.2013 dhe është regjistruar në emrin e Fatmir Lleshaj, më datë 17.05.2017.*

Lidhur me vlerën e blerjes së apartamentit deklaroi që është blerë në vitin 1998, në shumën 1.100.000 lekë në fazën e ndërtimit karabina, shtetasit H. H, në marrëdhënie besimi dhe me likujdim cash. Nuk është nënshkruar kontratë shitblerje midis midis babait dhe palës shitëse, për shkak të mirëbesimit dhe marrëdhënies miqësore që kanë patur. Për efekt provueshmërie, meqënëse shtetasi H. H ndodhet me banim në SHBA, në pamundësi objektive për të gjeneruar një deklaratë noteriale në këto momente, ka hartuar një deklaratë ku pasqyrohet shitja e apartamentit, vlera e tij, faza e ndërtimit dhe mënyra e pagesës.

Për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, nuk kanë mbajtur evidenca mbi kontributet e gjithsecilit prej anëtarëve të familjes, por deklaroi që vlera e kontributit të tij ka qenë modeste, për shkak të pamundësive financiare në atë kohë.

Babai Preng Lleshaj dhe vëllezërit F. Ll e T. Ll kanë punuar në një biznes familjar të gjeneruar nga Kooperativa Bujqësore Prosek Mirditë, ku babai ka punuar si marangoz/karpantjer, duke privatizuar objektin zdrukhtari.

Në vitin 1997 babai i'a ka shitur objektin zdrukhtari, pa makineritë, z. G. T dhe e ka spostuar aktivitetin në një objekt afër shtëpisë së tyre në Prosek , Mirditë.

Në vitin 1998, njëri nga vëllezërit është larguar në emigracion në Greqi dhe më pas në Angli, deri në vitin 2004, ku ka punuar dhe ka kontribuar në angazhimet familjare për jetesën normale dhe në rregullimin e apartamentit”.

Subjekti deklaron se i është drejtuar Unionit Financiar Tiranë, për të mundësuar kopje të transaksioneve Western Union të bëra nga vëllai F. Lleshaj dhe babai Preng Lleshaj gjatë kohës kur vëllai ka qenë emigrant në Angli, për periudhën 1998 – 2004, por për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar, është e pamundur gjetja e dokumentacionit të kërkuar.

Sqaroi se, vlera prej 1.500.000 lekë është deklaruar si vlerë për rregullim apartamenti dhe përshtatjen e tij për banim, e shprehur konkretisht me zëra punimesh dhe shpenzimesh në Akt – Ekspertizën Teknike Ekonomike të apartamentit. Vlera e mësipërme është e zhveshur nga haku i punës, strukturat e kostos së fillimit dhe nga TVSH, meqënëse objekti është ndërtuar në informalitet.

Vlera e mësipërme është kontribut i përbashkët i familjarëve, të ardhurat nga puna marangoz e babait Preng Lleshaj, të ardhurat nga emigracioni i vëllait F. Lleshaj në Angli, të ardhurat e bashkëshortes Leonora Lleshaj si infermiere në Drejtorinë e Shëndetit Publik Mirditë dhe të ardhurat e tij si oficer...”.

31.2 I pyetur për shpenzimet e mobilimit të pasurive të paluajtshme, subjekti rideklaroi vlerën e shpenzimeve të kryera për rregullimin (përshtatje për banim), arredim dhe mobilim apartamenti në vlerën 1.500.000 lekë, me kontribut dhe punë të përbashkët familjare, por nuk e ka të ndarë me zëra shifrën e sipërcituar. Në vitin 2014 apartamentit i është bërë një rimobilim modest në vlerën 100.000 lekë, kryesisht elektroshtëpiake. Për shkak të kohës së gjatë nuk disponon dokumentacionin e plotë lidhur me shpenzimet e kryera: **Paraqiti:**

- ✓ Certifikatë familjare e vitit 1988, kryefamiljar Preng Lleshaj + fëmijët.
- ✓ Vetdeklarim për legalizimin e shtesës, datë 28.07.2006, banesë 7-kat shumëfamiljare. Vërtetim nr. 945 prot., datë 14.07.2008, mbi statusin e përfshirjes së objektit të ndërtuar pa leje në procesin e legalizimit, drejtuar shtetasit Fatmir Lleshaj.
- ✓ Deklaratë e shtetasit H. H, datë 24.07.2023 (dërguar me postë elektronike), i cili deklaron se i ka shitur në mirëbesim shtetasit Preng Lleshaj, shtesën anësore të apartamentit të tij. Marrëveshja për shitjen e apartamentit është bërë në vitin 1997, nga familjarët e tyre me shtetasin Preng Lleshaj dhe likuidimi është bërë në janar të vitit 1998. Apartamenti është shitur i pa përfunduar dhe në proces ndërtimi karabina. Pagesa është bërë me para në dorë në vlerën 1.100.000 lekë.
- ✓ Librezë telefoni në emër të babait Preng Lleshaj.
- ✓ Vërtetim nr. ***/1 prot., datë 21.06.2023, nga ASHK Mirditë, për shtetasin Preng Lleshi, i cili përfitues i ligjit 7501 ka regjistruar pasurinë 244/4, fshati Prosek, lloji i pasurisë arë me sip. 500 m², nga të cilat 300 m² truall dhe 45 m² ndërtesë.
- ✓ Deklaratë noteriale e G. T, me nr. Rep. **** dhe nr. Kol ***, datë 21.06.2023, i cili konfirmon se ka blerë në vitin 1997 objektin zdrukhtari, me sip. 200 m², ndodhur në Prosek, shtetasit Preng Lleshaj, kundrejtë vlerës 750.000 lekë, shumën të cilën e ka likuiduar dorazi.
- ✓ Deklaratë e Kryeplakut të fshatit Prosek Mirditë z. A. Ll, për shtetasin Preng Lleshaj, i cili ka qenë banues i fshatit Prosek Mirditë dhe ka punuar marangoz në zdrukhtarinë e Kooperativës Bujqësore Prosek. Me vonë ai e ka privatizuar dhe ka zhvilluar aktivitetet privat deri në vitin 2003.
- ✓ Paraqitje në google maps e adresës ku ndodhet objekti.
- ✓ Akt-ekspertizë tekniko ekonomike e “Shtesës anësore 7 kate pranë objektit ekzistues 6 kate”, të apartamentit nr. *, në ndërtesën nr. **, Hyrja nr. *, Rruga “Nuçi Naçi”, Tiranë.
- ✓ Akt-ekspertizë e “Shtesës anësore 7 kate pranë objektit ekzistues 6 kate”, e cila është hartuar në vitin 2009, në funksion të procesit të legalizimit.
- ✓ Deklaratë noteriale nr. **** rep., nr. **** kol., datë 22.06.2023, e shtetasit F. Lleshaj, i cili deklaron se ka qenë emigrant në Angli gjatë viteve 1999 – 2004, duke punuar në disa vende pune

në sektorin e ndërtimit, lavazhit të automjeteve etj. Nga punësimi i tij ka siguruar të ardhura dhe ka kontribuar për rregullimin e shtëpisë së blerë në Tiranë, ku ai ka kontribuar me të vëllain Fatmir Lleshaj. Gjithashtu ka kontribuar për mbarëvajtjen dhe përmisimin e situatës ekonomike të familjes së tij, duke i dërguar kursimet monetare nëpërmjet shërbimit postar Western Union në emër të babait Preng Lleshaj. Për shumat që ka dërguar gjatë viteve 1999 – 2004, nuk disponon fatura apo mandate. B/lidhur dokument identifikues i F. Lleshaj.

- ✓ Shkresë “Kthim përgjigje” (postë elektronike), datë 14.06.2023, nga Unioni Financiar Tiranë, drejtuar Fatmir Lleshaj, në të cilën deklarohet se nuk disponon informacion për transaksionet e kryera në periudha më të gjata se pesë vjet nga momenti i paraqitjes së klientit.

ASHK konfirmon apartamentin e regjistrimit në emër të subjektit.

32. Për apartamentin me sipërfaqe 142.3 m², në Selitë, Tiranë, blerë në vitin 1998 dhe aplikuar për legalizim në vitin 2006, rezulton se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë justifikues ligjor lidhur me blerjen e tij, si dhe burimin financiar të vlerës së investuar në të, gjithësej 2.600.000 lekë.

33. Pavarësisht konstatimeve për apartamentin e mësipërm, për të është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1 të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

Shpenzime mobilimi për apartamentin janë deklaruar në shumën 100.000 leke në vitin 2014.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me sqarimet e subjektit, dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e ASHK.

PASURI TË LUAJTSHME

1. **Autoveturë tipi Volkswagen**, viti i prodhimit 2004, targa AA***YT, blerë më 16.09.2019. shkëmbyer me kontratë shkëmbimi nr. Rep. **** dhe nr. Kol. ***, datë 25.03.2022. **Vlera:** 2.200 euro. **Pjesa takuese:** nuk përcaktohet. **Burimi i krijimit:** të ardhura nga paga dhe shpërblime.
2. **Autoveturë tipi Volkswagen**, viti i prodhimit 2013, targa AB***BV, blerë më 25.03.2022. **Vlera:** 5.500 Euro. **Pjesa takuese:** 100%. **Burimi i krijimit:** shkëmbyer me kontratë shkëmbimi, i automjetit tip Volkswagen Golf 5 me targë AA***YT dhe 1.000 euro.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Kontratë shkëmbimi (pasuri e luajtshme), nr. **** Rep., nr. *** Kol., datë 25.03.2022, nënshkruar ndërmjet palëve; Fatmir Lleshaj dhe K. H (përfaqësues/administrator i subjektit Person Fizik K. H PF). Referuar kontratës, palët bien dakord të shkëmbejnë pasuritë e luajtshme në pronësi të tyre dhe si rezultat i shkëmbimit shtetasit Fatmir Lleshaj, i kalon në pronësi automjetin Volkswagen, vit prodhimi 2013, me targë AB***BV, nr. shasië WVVZZZ*****, ndërsa palës tjetër pjesëmarrëse në kontratë K. H-PF, i kalon në pronësi automjeti Volkswagen, viti i prodhimit 2004, targë AA***YT, nr. shasië WVVZZZ*****. Përveç sa më sipër, Fatmir Lleshaj do t'i japë K. H-PF, shumën prej 1.000 Euro.

34. DPSHTRR, me shkresë nr. *** Prot., datë 25.05.2023, konfirmon se ka në pronësi aktuale të Fatmir Lleshaj, automjetin me targë AB***BV. Gjithashtu, ky shtetas ka patur të regjistruar pranë këtij institucioni, automjetet me targë AA***YT, TR****E. **B/lidhur:**

- ✓ Kontratë shërbimi (pasuri e luajtshme) nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.03.2022, nënshkruar ndërmjet palëve Fatmir Lleshaj dhe K. H, përfaqësues/administrator i subjektit Person Fizik K. H - PF.
- ✓ Kontratë shitblerje automjeti nr. **** rep., nr. *** kol., datë 16.10.2019, nënshkruar ndërmjet palës shitëse A. Ll dhe palës blerëse Fatmir Lleshaj, të automjetit Volkswagen Golf, vit prodhimi 2004, kundrejt vlerës 1.600 euro. Palët deklarojnë se janë likuiduar mes tyre për këtë shumë shitblerje, jashtë zyrës noteriale. **B/lidhur** ndodhet deklarimi verbal i shitblerjes së automjetit nënshkruar nga A. Ll, datë 02.09.2019, në shtetin italian, kundrejt vlerës 800 Euro + deklarata e zhdoganimit të automjetit.
- ✓ Kontratë shitblerje pasuri e luajtshme, nr. **** Rep., nr. **** kol., datë 20.11.2020, nënshkruar ndërmjet palës shitëse dhe palës blerëse Person Fizik K. H, të automjetit Volkswagen Golf, kundrejt vlerës 3000 euro, shumë e cila është likuiduar totalisht jashtë zyrës noteriale.
- ✓ Dosja e automjetit me targë TR****E, e cila përmban dokumentacionin ligjor të çregjistrimit datë 28.02.2012, si dhe dokumentacionin e zhvendosjes së kartelës së automjetit në Prosek, Mirditë, me adresë në Tiranë, datë 26.02.1999.

34.1 Në proces-verbalin e datës 27.07.2023, subjekti ka dhënë shpjegime në lidhje me pasurinë e sipërcituar, konkretisht:

Subjekti u pyet për vlerat referuese të deklaruara, konkretisht të automjetit me targë AA***YT, në vlerën 2.200 euro (sipas kontratës, blerë në shumën 1.600 euro), si dhe automjetit me targë AB***BV në vlerën 5.500 euro (sipas kontratës, blerë në shumën 3.000 euro). Gjithashtu u pyet për arsyen e shkëmbimit të automjeteve.

Subjekti sqaroi se, targa e automjetit është AB***BV dhe jo AB***BV, sic e ka deklaruar. Vlerës së automjetit të blerë 1.600 euro jashtë Shqipërisë i ka shtuar vlerën e shpenzimeve të kryera shtesë, doganë, targa dhe siguracion. Për këtë arsye është deklaruar 2.200 euro.

Automjeti Volkswagen vit prodhimi 2013 është deklaruar 5.500 euro, duke përfshirë vlerën e automjetit të tij, vlerën shtesë të paguar prej 1.000 euro plus pagesa shtesë të kryera prej tij, si dhe prej personit kur ka blerë automjetin. Pra vlera e deklaruar është vlerë përlllogaritëse e automjetit që ai disponon pas shkëmbimit.

Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit:

34.2 Subjekti i vlerësimit Fatmir Lleshaj, u pyet nëpërmjet komunikimit me e-mail më datë 13.12.2023, në lidhje me pagesat shtesë të kryera për automjetin, ku subjekti sqaroi se:

*“...Vlera e përlllogaritur e autoveturave të shkëmbyera është përcaktuar duke studiuar tregun e autoveturave në momentin e shkëmbimit dhe nivelin e gjendjes motorrike dhe gjenerike të tyre. Vlera e autoveturës së përfituar me targë AB***BV është llogaritur si shumë e vlerës së autoveturës me targë AA***YT plus 1000 euro. Vlera e autoveturës me targë AA***YT në momentin e shkëmbimit është përcaktuar nga vlera e tregut dhe e përlllogaritur si vlerë në shkëmbim rreth 3800 (tremijë e tetëqind) deri 4000 (katër mijë) euro...”*

- **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me automjetet dhe vlerat e deklaruara prej tij, të cilave, përveç vlerave sipas kontratave, i ka shtuar edhe shpenzimet shtesë për doganë dhe regjistrim.**
- ✓ **Konfirmohen nga DPSHTRR kontratat e shitblerjes dhe shkëmbimit të automjeteve.**

34.3 Subjekti i vlerësimit Fatmir Lleshaj nëpërmjet komunikimit me e-mail më datë 17.11.2023, ku nga verifikimet e kryera ka rezultuar që ka pasur të regjistruar në emrin tij automjet tip Benz me targë TR**E.**

Për një hetim të plotë e të bazuar në ligj dhe në prova trupa e vlerësimit arsyetoi dhe verifikoi të gjitha faktet, rrethanat dhe thëniet e vet subjektit të deklarimit si më poshtë vijon:

“...Arsyeja e mospasqyrimit është thjesht një harresë për shkak të kohës së gjatë të fitimit të pronësisë të kësaj autoveture. Kjo autoveturë është blerë nga babai im Preng Lleshaj, rreth fundit të vitit 1996 – 1997, në vlerë rreth 300.000 lekë. Pronësia e autoveturës është bërë në emrin tim. Subjekti sqaroi gjithashtu se, këtë automjet për shkak të dëmtimit në mënyrë të pariparueshme në vitin 2000 e ka shitur në një varrezë automjete në vlerë rreth 80.000 lekë dhe e ka çrregjistruar më datë 28.02.2012...”

Konkluzion: Trupa e Vlerësimit nga gërshetimi i të dhënave të faktit, dokumentacionit të siguruar nga subjekti i vlerësimit si dhe DPSHTRR, konstaton se subjekti i vlerësimit pasqyron argumenta bindës mbi faktin e mospasqyrimit të këtij automjeti.

35. Llogari page në Raiffeisen Bank, me balancë në datën 06.03.2023. Vlera: 14.619 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: të ardhura nga paga, shpërblime, pagesa leje e zakonshme të pakryera dhe pagesë veshje uniforma. **Shuma 2.882.337 lekë.**

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Nxjerrje llogari page në emër të Fatmir Lleshaj, pranë RFZ Bank, gjatë periudhës 01.01.2021 - 06.03.2023. Gjendje në datë 06.03.2023, vlera 14.619 lekë.

35.1.Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** Prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogari page në emër të shtetasit Fatmir Lleshaj dhe gjendjen në datë 09.03.2023, në vlerën 93.996 lekë.

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar. Raiffeisen Bank konfirmon gjendjen e llogarisë në datë 09.03.2023, ndërsa subjekti i referohet gjendjes së datës 06.03.2023.

36.Llogari page në Credins Bank, me balancë në datën 02.03.2023. **Vlera:** 0 leke. **Pjesa takuese:** 100%. **Burimi i krijimit:** te ardhura nga paga. **Shuma:** 742.220 leke. **Statusi: mbyllur në datë 02.03.2023.**

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Nxjerrje llogarie në emër të Fatmir Lleshaj, pranë Credins Bank, gjatë periudhës 27.12.2019 - 02.03.2023. Gjendje në datë 02.03.2023, vlera 0 lekë.

36.1Credins Bank, me shkresën nr. *** Prot., datë 30.05.2023, konfirmon llogari në emër të Fatmir Lleshaj, me gjendje në datë 09.03.2023, vlera 0 lekë. Gjithashtu konfirmohet se në datë 02.03.2023, janë likuiduar komisionet përkatëse për mbylljen e llogarisë. Evidentohet se në këtë llogari, gjatë periudhës 27.12.2019 - 28.12.2020 janë kredituar paga nga subjekti “Jubica” shpk, gjithsej **rreth 739.000 lekë.**

- ✓ Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar dhe përgjigjen e Credins Bank.

DEKLARIMI I TË ARDHURAVE

- Te ardhura page dhe shpërblime nga funksioni si Drejtor i Drejorisë së Menaxhimit dhe Drejtimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, për periudhën 17.12.2020 - 06.03.2023. Shuma e të ardhurave 2.882.370 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Drejtor i Marrdhënieve të Punës në SHPK Jubica, për periudhën 01.12.2019 - 22.12.2020. Shuma e të ardhurave 742.220 lekë.
- Te ardhura nga funksioni Drejor në Drejorinë Vendore të Policisë Berat, për periudhën 16.06.2016 - 27.04.2017. Shuma e të ardhurave 1.565.941 lekë.

- Të ardhura nga funksioni Shef Komisaritati Policisë nr. 4 Tiranë, për periudhën 01.05.2015 - 15.06.2016. Shuma e të ardhurave 984.320 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Shef Komisaritati Policisë nr. 5 Tiranë, për periudhën 12.08.2013 - 30.04.2015. Shuma e të ardhurave 1.910.046 lekë.
- Të ardhurat nga funksioni Shef Seksioni i Mbrojtjes së të Miturve dhe Dhunës në Familje në Drejtorinë e Policisë Qarku Berat, për periudhën 03.11.2012 - 11.08.2013. Shuma e të ardhurave 664.700 lekë.
- Të ardhurat nga funksioni Shef Komisaritati Policisë Shkodër, për periudhën 05.10.2011 - 02.11.2012. Shuma e të ardhurave 500.962 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Shef Komisaritati Policisë Skrapar, për periudhën 12.03.2011 - 04.10.2011. Shuma e të ardhurave 257.000 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Shef Seksioni i Analizes së Informacionit Kriminal në Drejtorinë e Policisë Qarku Berat për periudhën 19.10.2010 - 11.03.2011. Shuma e të ardhurave 103.051 lekë.
- Për periudhën nga data 12.02.2008 - 18.10.2010, i pa punësuar. Përfituar pagat me vendim gjykatë. Shuma e të ardhurave 600.148 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Shef Seksioni Policisë Rrugore, në Komisarlatin e Policisë Shkodër, për periudhën 02.03.2008 - 11.04.2008. Shuma e të ardhurave 73.774 lekë.
- Për periudhën nga data 02.12.2003 - 01.03.2008, i pa punësuar. Përfituar pagat me vendim gjykatë. Shuma e të ardhurave 777.650 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Përgjegjës Linjash në Seksionin e Policisë Rrugore në Komisarlatin e Policisë Krujë, për periudhën 01.10.2003 - 01.12.2003. Shuma e të ardhurave 53.880 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Shef Nënseksioni Policisë Rrugore, në Komisarlatin e Policisë Kurbin, për periudhën 02.02.2003 - 30.09.2003. Shuma e të ardhurave 346.305 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Shef Seksioni Policisë Rrugore, për periudhën 01.01.2002 - 01.02.2003. Shuma e të ardhurave 327.097 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Komandant i Repartit të Rendit në Komisarlatin e Policisë Mirditë, për periudhën 19.06.2001 - 31.12.2001. Shuma e të ardhurave 346.305 lekë.

- Të ardhura nga funksioni Komandant i Repartit të Rendit në Komisarlatin e Policisë Vlorë, për periudhën 17.04.2001 - 18.06.2001. Shuma e të ardhurave 50.606 leke.
- Të ardhura nga funksioni Komandant i Postës së Policisë Kamzës, në Komisarlatin e Policisë Tiranë, për periudhën 01.05.2000 - 16.04.2001. Shuma e të ardhurave 180.000 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Oficer Informacioni në Drejtorinë e Policisë Qarkut Tiranë, për periudhën 01.02.1998 - 30.04.2000. Shuma e të ardhurave 130.000 lekë.
- Të ardhura nga funksioni Shef i Sektorit të Përgatitjes dhe Gadishmërisë në Komisarlatin e Policisë Nr. 1, Tiranë, për periudhën 02.09.1997 - 31.01.1998. Shuma e të ardhurave 30.000 lekë.
- Të ardhurat për periudhën 02.09.1997 - 06.03.2023, në shumën totale 12.526.375 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, për të ardhurat neto të realizuara nga Fatmir Lleshaj, gjatë periudhës 18.12.2020 - 28.02.2023, në total rreth 2.833.000 lekë.
- ✓ Vendim nr. 453, datë 18.04.2007, i Gjykatës së Apelit Tiranë, me objekt “Anullimin e urdhërit administrativ nr. 871/2, datë 02.12.2003, për përjashtim nga Policia e Shtetit”, në të cilën është vendosur detyrimi ndaj palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, të paguaj palës paditëse Fatmir Lleshi, pagën e një viti për kohën e qëndrimit pa punë.
- ✓ Vërtetim nga RFZ Bank, datë 24.04.2018, mbi produktet bankare të klientit Fatmir Lleshaj, gjatë periudhës 2005 – 2008.

37. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. 09/2 prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Fatmir Lleshaj dhe të ardhurat e kredituara nga pagat e dietat, gjatë periudhës 15.07.2005 - 15.12.2005; 03.04.2008 - 05.08.2008; 22.11.2010 - 03.05.2017 dhe 07.01.2021 - 04.03.2023, në vlerën totale prej rreth **8.938.000 lekë**.

Referuar lëvizjeve të llogarisë, rezulton se shtetasi Fatmir Lleshaj, në datë 05.09.2005, ka depozituar shumën 619.500 lekë, në datë 13.08.2007, shumën 600.000 lekë, në datë 29.12.2011, shumën 100.000 lekë.

Në datë 31.12.2014, është kredituar në llogari shuma 520.560 lekë, me përshkrimin “pagesë Fatmir Lleshaj”.

38. Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, konfirmon se shtetasi Fatmir Lleshaj, ka pasur llogari page, në të cilën gjatë periudhës 27.12.2019 - 28.12.2020, janë kredituar paga nga

subjekti “Jubica” shpk, gjithsej rreth **739.000 lekë**. Gjatë kësaj periudhë rezulton se pagat janë kredituar në llogari, por nuk janë tërhequr deri në datë 28.12.2020.

39.ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, konfirmon të ardhura të realizura nga Fatmir Lleshaj, gjatë periudhës janar 2012 - nëntor 2012, pranë Komisaritit të Policisë Shkodër, dhjetor 2012 - gusht 2013 dhe qershor 2016 - prill 2017, pranë Drejtorisë së Policisë Berat; gusht 2013 - qershor 2016, pranë Drejtorisë së Policisë; tetor 2019 - dhjetor 2020, prane subjektit “Jubica” shpk dhe dhjetor 2020 – mars 2023, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë.

40.Në process-verbalin e mbajtur në datë 27.07.2023, subjekti sqaroi se:

- Vlerat e deklaruara prej tij, i referohen të ardhurave të kredituara në total, gjatë periudhës dhjetor 2003 - tetor 2010, në Raiffeisen Bank. Gjatë kësaj periudhe ka patur periudha punësimi të shkurtra në strukturat policore të shtetit, konkretisht pranë IKMT (6 muaj/viti 2005) dhe Drejtorinë e Policisë Shkodër (40 ditë/viti 2008). Në vitin 2003 është larguar padrejtësisht nga policia dhe ka përfituar dëmshpërblim me Vendim Gjyqësor, pagën e një viti, shumë e kredituar kjo në vitin 2014, në vlerën rreth 520.000 lekë. Ka filluar punë në vitin 2005 në strukturën e IKMT-së Tiranë, dhe ka punuar aty 6 muaj deri në 31 tetor 2005, pasi është larguar me kërkesën e tij për të emigruar jashtë vendit.
- Në dhjetor të vitit 2005 ka emigruar në Greqi në zonën Veria, ku ka punuar rreth 6 muaj dhe më pas është rikthyer në Shqipëri. Pas 10 ditësh është larguar përsëri në Greqi, duke u vendosur në zonën e Marmara të ishullit Kos, në Greqi, ku ka punuar deri në datë 31.06.2007 (rreth 13 muaj). Para këtyre periudhave të punësimit, ka patur edhe një periudhë tjetër punësimi nga data 15.01.2004 deri në 10.10.2004, në zonën e Giannitsa, Greqi.
- **Për sa më sipër paraqiti lëvizjet në sistemin TIMS 2004 - 2007 dhe pasaportën e vizën përkatëse.**
- Është rikthyer në Shqipëri në datë 31.06.2007, dhe të ardhurat të cilat i ka përfituar nga emigracioni i ka përdorur për të paguar një borxh rreth 200.000 lekë shtetasit A. Gj dhe të tjera për shpenzime familjare. Gjatë periudhës 2003 – 2010, ka përfituar të ardhura në vlerën rreth 1.452.000 lekë, deklaruar prej tij në shumat 600.148 lekë, 73.774 lekë, 777.650 lekë, të cilat janë kredituar ne Raiffeisen bank, pjesërisht prej tij dhe pjesërisht nga institucionet ku ka punuar.

Konkretisht:

- Të ardhurat nga IKMT, të ardhura hua nga shtetasi A. Gj, për marrjen e vizës, të ardhura në formë suporti ekonomik nga babai i bashkëshortes Pjeter Lleshaj dhe të ardhura nga Drejtoria e Policisë Shkodër. Për periudhën e sipërcituar ka përfituar dy dëmshpërblime gjyqësore, kredituar në periudhen 2011 dhe 2014. Në vitin 2011 ka përfituar shumën rreth 188.000 lekë, nga Zyra

Përmbaremore Shkodër dhe në vitin 2014 ka përfituar shumë rreth 520.000 lekë, kredituar nga Drejtoria e Policisë Shkodër në llogarinë e tij në Raiffeisen Bank.

- Të ardhurat nga emigracioni, të cilat kanë shërbyer në periudha të caktuara për shpenzimet e konsumit të tij familjar, nuk i ka deklaruar për shkak se nuk disponon një vlerë të saktë dhe dokumentacion përkatës, pasi ka punuar në informalitet.
- Të ardhurat nga vendimet gjyqësore janë deklaruar duke iu referuar periudhës për të cilën ka marrë dëmshpërblim 2003 - 2008; 2008 - 2010 dhe jo periudhës kur janë kredituar fondet.
- Për të ardhurat që kanë shërbyer për konsum familjar, për periudhën 27.12.2019 - 28. 12.2020, subjekti sqaroi që kanë shpenzuar të ardhurat nga kursimet e tij dhe të bashkëshortës, të cilat ishin gjendje në Raiffeisen Bank.
- Depozitimi i datës 05.09.2005, në vlerën 619.000 lekë, në Raiffeisen Bank, është bërë për shkak të aplikimit në atë kohë për një vizë në shtetin grek, ku kusht kryesor ka qenë garancia bankare. Këto të ardhura janë marrë hua nga shtetasi A. Gj, i cili ka qenë oficer policie dhe ka pasur biznes familjar agjenci turistike.
- Depozitimi me vlerë 100.000 lekë, është gjeneruar nga kursime familjare.
- Për depozitimin e datës 13.08.2007, në vlerën 600.000 lekë në Raiffeisen Bank, sqaroi se këto të ardhura janë gjeneruar nga shuma e marrë shtetasit Pjeter Zef Lleshaj (babai i bashkëshortes) për ta përdorur si garanci për vizë udhëtimi për në shtetin italian, si dhe paga si specialist në Drejtorinë e Policisë Ndërtimore, sot Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT).
- **Lidhur me kreditimin në vlerën 520.560 lekë, në datën 31.12.2014**, në Raiffeisen Bank, veprimi është bërë nga Komisarati i Policisë Shkodër. Këto të ardhura janë gjeneruar nga Vendimi i Gykatës së Apelit Tiranë, me nr. 453.

Për sa më sipër subjekti paraqiti:

- ✓ Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 30.06.2023, nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë drejtuar Fatmir Lleshaj, për të ardhurat e përfituara nga paga dhe të tjera (leje vjetore, shpërblime, orë suplementare etj), gjatë periudhës 1997 - maj 2001. Shuma totale 951.505 lekë.
- ✓ Vërtetim page nga Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë, për Fatmir Lleshaj dhe të ardhurat e realizuara për periudhën 16.04.2001 - 15.08.2001. Shuma totale neto 68.685 lekë.

- ✓ Vërtetim page nga Drejtoria Vendore e Policisë Lezhë, për Fatmir Lleshaj dhe të ardhurat e realizuara për periudhën gusht 2001 - 31.12.2001 dhe 01.02.2003 - 30.09.2003 (muajt prill/maj janë pa vlerë). Shuma totale neto 337.998 lekë.
- ✓ Vërtetim page nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, për Fatmir Lleshaj dhe të ardhurat e realizuara për periudhën 01.01.2002 - 31.01.2003. Shuma totale neto 353.095 lekë.
- ✓ Vërtetim page nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës për Fatmir Lleshaj dhe të ardhurat e realizuara për periudhën 01.10.2003 - 30.11.2003. Shuma totale neto 83.380 lekë.
- ✓ Vërtetim punësimi lëshuar nga IKMT, me nr. *** prot., datë 14.06.2023, për Fatmir Lleshaj, i cili ka qenë punonjës në Drejtorinë e Policisë së Ndërtimit (sot IKMT), nga data 20.05.2005 - 04.11.2005.
- ✓ Vendim i Gjykatës së Rrethit Shkodër nr. ****, datë 31.07.2008, me objekt “*anulimin e urdhërit ekzekutiv nr. 569/2, datë 10.04.2008, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë*”. Sipas vendimit, gjykata vendosi anulimin e aktit administrativ dhe detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Policisë Qarku Shkodër, të dëmshpërblejë paditësin Fatmir Lleshi me 3 muaj page mujore, për dëmin ekonomik të shkaktuar. Vendimi është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Shkodër. **B/lidhur:** Vendim nr. 49, datë 30.1.2009, i Gjykatës së Apelit Shkodër.
- ✓ Urdhër i brendshëm nr. ****, datë 13.10.2011, i Drejtorisë së Policisë për zbatimin e Vendimit të Gjykatës nr. 49, datë 30.01.2009, dhe likuidimin e kreditorit Fatmir Lleshi nëpërmjet Zyrës së Përmbarrimit Shkodër, në vlerën 188.325 lekë.
- ✓ Urdhër shpenzimi nr. ***, datë 15.10.2011, i Drejtorisë së Policisë Qarku Shkodër.
- ✓ Deklaratë noteriale huadhënie nga A. Gj, Nr. *** Rep., Nr. *** Kol., datë 25.07.2023, i cili deklaroi se në datë 01.09.2005, i ka dhënë hua pa interes në mirëbesim shtetasit Fatmir Preng Lleshaj, shumën 630.000 lekë, e cila do të përdorej prej tij si garanci për vizën shengen greke. Shuma është përfituar nga aktiviteti i shoqërisë “***** Travel” shpk., në të cilën bashkëshortja e tij ka qenë ortak e vetme. Huaja është likuiduar nga Fatmir Lleshaj në dy pjesë, pjesa e parë prej 400.000 lekë i është kthyer nga babai i tij në formë mobilimi të apartamentit të tij ndodhur në Tiranë, në rrugën “Sami Frashëri”, ndërsa diferenca 230.000 lekë është likuiduar, pasi Fatmir Lleshaj është kthyer nga Greqia. **B/lidhur** mjete identifikues i A. Gj, si dhe certifikata e regjistrimit të aktivitetit tregtar **** Travel, në QKB, datë. 01.04.2002, NIPT K3*****Q.
- ✓ Fotokopje e pasaportës, vizës Greke dhe lëvizjet në sistemin TIMS, për periudhën 2005-2007. Evidentohet dalja në datë 31.10.2005, nga Pika e Kalimit Kufitar Kakavijë.

- ✓ Deklaratë noteriale e Pjetër Lleshaj, Nr. **** Rep. dhe Nr. *** Kol., datë 21.06.2023, i cili deklaroi se në vitet 2004 deri në 2007 ka ndihmuar gjatë gjithë kohës familjen e vajzës Leonora Lleshaj, e përbërë nga katër pjesëtarë, pasi kanë qenë të dy të papunë, duke i suportuar ekonomikisht, gjithashtu edhe pas kësaj periudhe, me vlera financiare për të cilat nuk ka evidencë për shkak të marrëdhënieve familjare. Ai deklaroi se në datë 01.08.2008, i ka dhënë shumën 650.000 lekë, për garanci për vizë italiane dhe shpenzime të tjera. Burimi i të ardhurave vjen si rezultat i biznesit të tij privat, Person Fizik, regjistruar me NIPT K*****Q dhe në vazhdim pas daljes në pension, në emër të djalit G. N (Lleshaj), me NIPT L*****C.
- ✓ Vërtetim nr. **** prot., datë 20.06.2023, i Bashkisë Mirditë, për aktivitetin tregtar të subjektit P. Lleshaj, i cili ka ushtruar aktivitetin “shitje me pakice” në Rrëshen Mirditë, gjatë periudhës 2003 - 2009. Rezulton se nuk ka detyrime të pashlyera.
- ✓ Ekstrakt historik i regjistrimit tregtar, në emër të P. Lleshaj, NIPT K*****Q, regjistruar në datë 29.07.1991, me Vendimin e Gjykatës Rrëshen dhe në datë 03.04.2009, kaluar në status “çregjistruar”.

41. Konstatohet: Subjekti ka patur periudhë papunësie pas largimit nga puna në Policinë e Shtetit, në dhjetor 2003 - tetor 2010, periudhë gjatë së cilës ka deklaruar se ka punuar në emigracion sezonal në Greqi, konkretisht rreth 9 muaj në vitin 2004, 6 muaj në vitin 2005 dhe 13 muaj në vitin 2006 - 2007, ku me të ardhurat e përfituara ka përballuar një pjesë të shpenzimeve të jetesës deri në vitin 2010. Ka paraqitur vetëm shpjegime dhe kopje të vizave greke.

- ✓ Të ardhurat e subjektit nga paga, shpërblimet dhe vendimet gjyqësore, për periudhën 1997 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 11.660.000 lekë (pa përfshirë të ardhurat nga emigracioni).
- ✓ Subjekti ka dhënë shpjegime se gjatë viteve 2004 - 2010, kur ka qenë në periudhë papunësie, shpenzimet e konsumit familjar janë përballuar nga të ardhurat e tij nga emigracioni sezonal, ndihmë nga prindërit e bashkëshortes dhe huamarrje, për të cilat mungon dokumentacioni i pjesshëm justifikues financiar. Referuar realizimit të të ardhurave (rrjedhimisht edhe shpenzimeve) për periudhën deri në vitin 2008, është i aplikueshëm neni 32, pika 1.1 të Ligjit nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Cështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar.

SHPENZIMET E DEKLARUESHME

Të vitit të fundit kalendarik për qira banese, ujë, drita, telefon dhe internet, si dhe të gjitha ato pagesa periodike për kontratat e furnizimit apo pajtimit në emër të subjektit ose personave të lidhur - Periudha 01.01.2022 - 31.12.2022.

- Shpenzime për drita, periudha 01.01.2022 - 31.12.2022. Shuma 85.976 lekë;
- Shpenzime për ujë, periudha 01.01.2022 - 31.12.2022. Shuma 30.662 lekë;
- Shpenzime për internet për periudhën 1.1.2022 - 31.12.2022. Shuma 12.000 lekë;
- Shpenzime për telefonat për periudhën 01.01.2022-31.12.2022, për numrat ...777; ..234; ... 339; ... 320; 795. **Shuma 69.500 lekë.**

❖ **Nuk ka paraqitur dokumentacion bashkëlidhur deklaratës.**

42. Vodafone Albania sh.a, me shkresën nr. ***, datë 13.07.2023, konfirmon dokumentacionin ligjor për pajisjen me numër kontakti të Fatmir Lleshaj, Leonora Lleshaj dhe Pamela Lleshaj. Konkretisht konfirmohen në emër të Drejtorisë së Policisë Berat (Fatmir Lleshaj) një numër telefoni (nr. ...320) aktiv prej 09.11.2010 dhe në emër të Fatmir Lleshaj dy numra telefoni (nr. . .795) aktiv prej 29.03.2022 (nr. ...777) aktiv prej 27.07.2015.

- Në emër të Leonora Lleshaj konfirmohen dy numra telefoni (nr. ...234) aktiv prej 27.09.2016, (nr. 339) aktiv prej 27.10.2017.
- Në emër të Pamela Lleshaj konfirmohet një numër telefoni inaktiv, prej datës 10.10.2019.

Gjithashtu, evidentohet vlera e faturimit vjetor të numrit në emër të:

- Fatmir Lleshaj (nr. ...795) ne vlerën 12.629 lekë; (nr. 777) në vlerën 24.780 lekë; (nr... .320) në vlerën 8.400 lekë.
- Leonora Lleshaj (nr.....234) në vlerën 12.000 lekë; (nr. ... 339) ne vlerën 11.300 lekë.

43. One Albania sh.a, me shkresën nr. ***, datë 07.06.2023, konfirmon se në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të, **nuk rezulton** të ketë numra të regjistruar në shërbimin e telefonisë mobile, fikse dhe interneti.

44. Albania Satellite Communications shpk, me shkresën nr. *** prot, datë 15.05.2023, konfirmon se për periudhën e kërkuar, shtetasi Fatmir Lleshaj dhe personat e lidhur me të, **nuk kanë** nënshkruar kontratë me shoqërinë.

45. Abissnet sh.a, me shkresën nr. V- prot, datë 11.05.2023, **nuk konfirmon** kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

46. Digicom sh.a, me shkresën nr. *** prot, datë 12.05.2023, **nuk konfirmon** kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.

47. FSHU, me shkresën *** prot., datë 15.05.2023, nuk konfirmon kontrata furnizimi me energji elektrike me gjeneralitetet Fatmir Preng Lleshaj, ndërsa me gjeneralitetet Fatmir Lleshaj, konfirmon dy abonentë me kontratë furnizimi në instancat Tiranë, me nr. TRI003008***** dhe në Durrës me nr. DU0A0600*****.
48. **Shoqëria Rajonale Ujësjellës - Kanalizime Tiranë**, me shkresën *** prot., datë 24.05.2023, konfirmon se në emër të Fatmir Lleshaj, rezulton kontrata nr. 380299-1, për objektin me adresë në rruga “Irfan Tomini”, me status “aktiv”, në kategorinë e konsumatorëve familjare, me detyrime të likuiduara deri në muajin shkurt 2023. **B/lidhur** dokumenti i identifikimit, si dhe leja e legalizimit të objektit.
49. **14 Shoqëritë Rajonale të Ujësjellës - Kanalizime**, me shkresat nr. **** - **** prot, **nuk konfirmojnë** kontrata të lidhura nga subjekti dhe personat e lidhur me të.
50. **Në proces - verbalin e mbajtur në datë 27.07.2023,** subjekti paraqiti fotokopje të librezave të ujit, energjisë, faturat vjetore për dy numrat që ka deklaruar, lëshuar nga Vodafon AL, shpenzime këto për vitin 2022.

Konkretisht:

- Librezë e Ujësjellës Kanalizime, për kontratën nr. *****, në emër të Fatmir Lleshaj, vlerë totale e faturuar për vitin 2022, në shumën rreth 31.000 lekë.
 - Librezë e OSHEE, për kontratën nr. O/*****, Rruga “Irfan Tomini” në emër të Fatmir Lleshaj, vlerë totale e faturuar për vitin 2022, në shumën rreth 73.000 lekë.
 - Faturë e Vodafone për abonentin Fatmir Lleshaj (2 numra), vlerë e faturuar për vitin 2022 në shumën rreth 19.500 lekë.
- ✓ **Shpenzimet e deklaruara për ujë + drita + telefoni + internet, gjatë periudhës së sipërcituar, me kontrata në emër të subjektit dhe/apo personave të lidhur me të, rezultojnë në total rreth 198.000 lekë.**
51. **Për udhëtimet private, personale apo të personave të lidhur jashtë territorit shqiptar gjatë 3 viteve të fundit (kalendarike), duke specifikuar shtetin, vendin e qëndrimit, kohëzgjatjen dhe shpenzimet e përballuara - Periudha 01.01.2020 - 31.12.2022.**
- Shpenzime për udhëtimin e Fatmir Lleshaj në Itali, në datat 11.05.2022 - 14.05.2022, në Colonio Mozese, Milano (banesë e vëllait). Shuma 450 euro.
 - Shpenzime për udhëtimin e Fatmir Lleshaj në Kosovë, në datat 06.02.2021 - 07.02.2021, në Pejë. Shuma 150 euro.
 - Shpenzime për udhëtimin e Fatmir Lleshaj në Kosovë, në datën 06.02.2020, në Prizren. Shuma 120 euro.

- Shpenzime për udhëtimin e Leonora Lleshaj në Malin e Zi, në datat 11.05.2022 - 12.05.2022 në Podgoricë. Shuma 120 euro.
- Shpenzime për udhëtimin e Leonora Lleshaj në Malin e Zi, në datë 19.05.2020, në Podgoricë. Shuma 100 euro.
- Shpenzime për udhëtimin e Pamela Lleshaj, në Malin e Zi, në datat 11.05.2022 - 12.05.2022, në Podgoricë. Shuma 150 euro.

52. Me inventarin datë 10.07.2023, subjekti paraqiti raportin TIMS për të dhe familjarët e tij. Referuar sistemit TIMS të paraqitur nga subjekti evidentohen:

Fatmir Lleshaj:

Dalje 06.02.2021 - Hyrje 07.02.2021.

Dalje 11.05.2022 - Hyrje 14.05.2022.

Leonora Lleshaj:

Dalje 19.01.2020 - Hyrje 19.01.2020.

Dalje 11.05.2022 - Hyrje 12.05.2022.

Pamela Lleshaj:

Dalje 19.01.2020 - Hyrje 19.01.2020.

Dalje 11.05.2022 - Hyrje 12.05.2022.

Xhoardo Lleshaj:

Dalje 25.01.2021 - Hyrje 26.01.2021.

53. Në proces-verbalin e datës 27.07.2023, subjekti paraqiti dokumentacionin përkatës nga sistemi TIMS, për të dhe familjarët. Deklaroi se nga verifikimi i dokumentacionit TIMS, përveç sa deklaruar, rezulton edhe një udhëtim i kryer nga djali në datën 25.01.2021, në Kosove, Brezovice. Udhëtimi ka patur afat 1 ditë (një natë qëndrimi në hotel dhe rruga vajtje - ardhje dy ditë). Në këtë udhëtim ka shpenzuar rreth 70 euro për akomodim dhe ushqim.

- ✓ **Konfirmohet deklarimi me dokumentacionin e dorëzuar sa i përket hyrje – daljeve nga RSH, gjatë periudhës 2020 - 2022, të subjektit dhe personave të lidhur me të.**
- ✓ **Shpenzimet e deklaruara për udhëtimet private, personale dhe të personave të lidhur gjatë periudhës së sipërcituar rezultojnë në total rreth rreth 1.100 euro, konvertuar rreth 126.000 lekë. Ku referuar të dhënave mbi të ardhurat konstaton se subjekti i vlerësimit ka pasur të ardhura për të mbuluar shpenzimet e udhëtimeve të tre viteve të fundit.**

54. Për arsimin e fëmijëve, madhorë apo te mitur, apo të personave të lidhur, duke deklaruar fillimin, llojin e institucionit arsimor, emrin e institucionit, pagesat vjetore, si dhe kohëzgjatjen e studimeve, sipas periudhës së përcaktuar në nenin 32, te Ligjit te vlerësimit - Periudha nga data e fillimit të punës në institucionin e Policisë së Shtetit, Gardës së

Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë.

- a. Shpenzime për shkollimin e vajzës Pamela Lleshaj, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë në vitet 2017 - 2020 (programi bachelor 3 vite × 35.000 lekë) dhe 2020 - 2022 (programi master 2 vite x 105.000 lekë). **Shuma 315.000 lekë.**
- b. Shpenzime për shkollimin e djalit Xhoardo Lleshaj në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Informatike, në vitet 2019 - 2023 (program bachelor 3 vite x 25.000 lekë). **Shuma 75.000 lekë.**

Në proces-verbalin e datës 27.07.2023, subjekti paraqiti dokumentacion, mandat pagese nga Pamela Lleshaj, për Fakultetin e Ekonomisë dhe nga Xhoardo Lleshaj për Fakultetin e Inxhinierisë.

- ✓ **Shpenzimet e deklaruara për arsimimin e fëmijëve, gjatë periudhës deri në ditën e plotësimit të formularit të deklarimit të pasurisë, rezultojnë në total 390.000 lekë.**
- ✓ **Referuar të dhënave mbi të ardhurat e subjekti i vlerësimit, konsatatohet mundësia për të mbuluar shpenzimet e arsimit.**

DEKLARIMITI BASHKËSHORTES - LEONORA LLESHAJ

55. Llogari page në OTP Bank, me balancë në datën 07.03.2023. Vlera: 853.586 lekë. Pjesa takuese: 100%. Burimi i krijimit: nga kursimet nga paga dhe të ardhurat familjare.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Lëvizjet e llogarisë në emër të Leonora Lleshaj pranë OTP Bank, gjatë periudhës 27.01.2021 - 07.03.2023. Gjendja në llogari datë 07.03.2023, në vlerën 853.586 lekë.
 - a. **OTP Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 05.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Leonora Lleshaj, me gjendje në datë 09.03.2023, vlerën 54.701 lekë. Referuar lëvizjeve të llogarisë **b/lidhur** shkresës, gjendja në llogari datë 09.03.2023, është në vlerën 853.586 lekë.

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga si Infermiere pranë Drejtorisë së Shëndetit Publik Mirditë, për periudhën 01.01.2021 - 07.03.2023. Shuma e të ardhurave 853.586 lekë.
- Të ardhura nga paga në Policinë e Shtetit si bashkëshorte punonjësi policie, për periudhën 2013 - 27.04.2017. Shuma e të ardhurave 480.828 lekë.

- Të ardhura nga paga si punonjëse prane SHPSF “Miri” Shkodër, për periudhën 06.06.2012 - 21.03.2013. Shuma 185.592 lekë.
- Të ardhura nga paga si infermiere pranë Drejtorise se Shëndetit Publik Mirditë, për periudhën 01.06.1998 - 15.02.2002. Shuma 155.000 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- Vërtetim nga ISSH për bazën e vlerësuar të kontributeve të deklaruara nga shtetasja Leonora Lleshaj. Për periudhën qershor 2012 - mars 2013, ka përfituar të ardhura neto pranë shoqërisë “Miri” shpk, në total 185.600 lekë.
- Nxjerrje llogarie page në emër të Leonora Lleshaj pranë Raiffeisen Bank, gjatë periudhës 31.05.2013 - 25.04.2018.

56. Raiffeisen Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Leonora Lleshaj dhe të ardhurat e kredituara nga pagat e ndihma, gjatë periudhës 03.06.2013 - 01.04.2015; 16.11.2015 - 01.07.2016 dhe 10.01.2017 - 03.05.2017, në vlerën totale prej rreth 782.000 lekë.

57. Tirana Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 12.05.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Leonora Lleshaj dhe të ardhurat e kredituara nga pagat, gjatë periudhës 10.06.2011 - 11.08.2011, në vlerën totale prej rreth 28.200 lekë.

58. OTP Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 5.5.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të Leonora Lleshaj, në të cilën janë kredituar paga gjatë periudhës 27.01.2021 - 07.03.2023, në vlerën totale prej 1.422.535 lekë.

59. ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, konfirmon të ardhura të realizuara nga Leonora Lleshaj, gjatë periudhës qershor 2012 - mars 2013, pranë subjektit “Miri” në shumën totale neto 301.238 lekë, maj 2013 - gusht 2013 dhe janar 2017 - prill 2017, pranë Drejtorisë së Policisë Berat; tetor 2013 - korrik 2016, pranë Drejtorisë së Policisë; janar 2021 - mars 2023, pranë Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Mirditë.

60. Në proces - verbalin e mbajtur në datë 27.07.2023, subjekti u pyet për vlerën referuese të të ardhurave nga bashkëshortja e tij, deklaruar në vlerën 853.586 lekë, ndërkohë që banka OTP konfirmon vlerën 1.422.000 lekë.

Subjekti sqaroi se bashkëshortja ka deklaruar vetëm gjendjen në momentin e deklarimit dhe jo kreditimet, fakt që përputhet tërësisht me vlerën 1.422.000 lekë dhe deklaroi se ka qenë një

paqartësi dhe gabim njerëzor. Bashkeshortja gjatë ushtrimit të detyrës ka jetuar në banesën e prindërve të saj në Rrëshen (Mirditë), në adresën;

Lagja “Zalli Smeja” Nd. * H.* Rrëshen. Banesa është në proces legalizimi në emër të babait të bashkëshortes, Pjeter Lleshaj. **Paraqiti:**

- Vërtetimi i aplikimit për legalizim nr. *** prot. dhe lëshuar më datë 14.01.2021, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Drejtoria Rajonale Lezhë).
- ✓ **Të ardhurat e bashkëshortes nga paga, për periudhën qershor 2011 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 2.534.000 lekë.**

DEKLARIMI I VAJZËS - PAMELA LLESHAJ

61. Llogari rrjedhëse pranë American Bank of Investments, me balancë në datën 06.03.2023. **Vlera:** 7.352 lekë. **Pjesa takuese:** 100%. **Burimi i krijimit:** nga kursimet nga pagat dhe shpërblimet.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

- ✓ Nxjerrje e llogarisë në emër të Pamela Lleshaj, pranë ABI Bank, gjatë periudhës 01.01.2022 - 06.03.2023. Gjendje në llogari datë 06.03.2023, në vlerën 7.352 lekë.

62. Abi Bank, me shkresën nr. **, datë 08.05.2023, konfirmon se Pamela Lleshaj disponon llogari me gjendje në datë 09.03.2023, në vlerën 33.701 lekë.

- ✓ **Konfirmohet llogaria rrjedhëse e vajzës në ABI Bank.**

DEKLARIMI I TE ARDHURAVE

- Të ardhura nga paga si punonjëse (specialiste finance) në O.SH.E.E Tiranë. Shuma e të ardhurave 225.446 lekë.

➤ **Bashkëlidhur deklaratës:**

63. Abi Bank, me shkresën nr. **, datë 08.05.2023, konfirmon llogarinë e pagës në emër të Pamela Lleshaj dhe pagat e kredituara gjatë periudhës 08.11.2022 - 09.03.2023, në shumën totale prej 278.795 lekë.

64. **Credins Bank**, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, konfirmon se shtetasja Pamela Lleshaj ka patur llogari, në të cilën, gjatë periudhës 13.04.2011- 10.06.2015; 2019, janë kredituar të ardhura nga bursa “*dhënie stimuli nxënës me rezultate*” gjithsej rreth 81.000 lekë.

✓ **Të ardhurat e vajzës nga bursa për periudhën 13.04.2011 - 10.06.2015 dhe nga paga për periudhën nëntor 2022 - mars 2023, konfirmohen në vlerën totale rreth 360.000 lekë.**

DEKLARIMI I DJALIT - XHOARDO LLESHAJ

65. Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, personi i lidhur me të Xhoardo Fatmir Lleshaj, i biri i subjektit të vlerësimit, nuk ka deklaruar pasuri (të luajtshme + paluajtshme), në emër të tij.

66. **Trupa e vlerësimit dhe ILDKPKI, nga verifikimet e kryera për personin e lidhur me subjektin, ka rezultuar se nuk disponon asnjë pasuri, çka konfirmohet me deklarin e personit të lidhur Xhoardo Lleshaj.**

67. Në Deklaratën e Pasurisë për vlerësimin kalimtar, subjekti Fatmir Lleshaj ka deklaruar adresën e plotë ku është regjistruar në Gjendjen Civile, si dhe adresën e plotë ku banon:

*Njësia Administrative nr. 5, Rruga "Nuçi Naçi" **/*/* Tiranë.*

68. **Banka e Shqipërisë, BKT, Intesa Sanpaulo Banka e Bashkuar e Shqipërisë, ProCredit Bank, Banka e Parë e Investimeve, Union Bank, Raiffeisen Leasing, Porsche Leasing, Albania Leasing, Landeslease, Raiffeisen Invest, Credins Invest, Fondi Besa, NOA, IUTE Credit, Kreda.al, konfirmojnë se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk janë klientë të tyre, çka konfirmohet me deklarin.**

69. **ASHK - Drejtoritë/Zyrat Vendore: Tirana Veri, Kamzë Vorë, Tiranë Rurale 1, Tiranë Rurale 2, Zona te Stimuluara, Tepelenë, Përmet, Mirditë, Peqin, Pukë Bulqizë, Tropojë, Kukës, Skrapar, Has, Kolonjë, Elbasan, Mallakastër, Lezhë, Lushnje, Gramsh, Malësi e Madhe, Kuçovë, Kavajë, Korçë, Berat, Fier, Pogradec, Gjirokastër, Librazhd, Devoll, Krujë, Mat, DV Durrës, Kurbin, Dibër, Sarandë, nuk konfirmojnë pasuri të paluajtshme në emër të subjektit dhe personave të lidhur me të.**

70. **Raiffeisen Bank**, me shkresën nr. ** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se shtetasja Leonora Lleshaj ka patur llogari rrjedhëse, në të cilën janë kredituar paga gjatë periudhës qershor 2013 - maj 2017. Pas kësaj periudhe janë kryer vetëm transaksione tërheqje fondesh në ATM, deri në mars 2022. Gjendje në datë 09.03.2023, në vlerën 99.165 lekë.

70.1 Në proces – verbalin e mbajtur në datë 27.07.2023, lidhur me llogarinë e bashkëshortes në RFZ Bank dhe arsyen e mosdeklarimit të saj, subjekti sqaroi se për shkak të paqartësive dhe mosnjohjes

së procesit, bashkëshortja ka harruar të bëjë deklarin e kësaj llogarie rrjedhëse në Raiffeisen Bank. Deklaroi që ka qenë lapsus padijenie dhe nuk ka patur arsye të tjera.

70.2 RFZ Bank konfirmon llogari në emër të bashkëshortes, me gjendje në vlerën 99.165 lekë, që nga viti 2017, me burim te ardhura nga pagat, të deklaruara.

71. Tirana Bank, me shkresën nr. ** prot., datë 12.05.2023, konfirmon se shtetasja Leonora Lleshaj ka patur llogari rrjedhëse, me gjendje në datë 09.03.2023, në vlerën 5.007 lekë. Në llogari nuk janë kryer veprime prej periudhës gusht 2011. Aktualisht llogaria është me status “Dormant”.

72. Credins Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 30.05.2023, konfirmon llogari rrjedhëse në emër të shtetases Pamela Lleshaj, me gjendje në datë 09.03.2023, në vlerën gjithsej 24.680 lekë.

73. Unioni Financiar Tiranë, me shkresën nr. ** prot., datë 09.05.2023, konfirmon transaksione financiare në emër të familjarëve të subjektit që i përkasin periudhës 26.04.2018 - 09.03.2023, konkretisht Xhoardo Lleshaj ka 8 transaksione (EUR) në hyrje me vlerë 1.428 euro; dhe 6 transaksione (ALL) me vlerë 142.506 leke; Leonora Lleshaj ka 2 transaksione (EUR) në hyrje me vlerë 372 euro dhe 1 transaksion (ALL) me vlerë 13.323 lekë; Pamela Lleshaj ka 1 transaksion (EUR) me vlerë 100 euro, si dhe 1 transaksion (EUR) në dalje me vlerë 700 euro.

74. AK Invest, me shkresën nr. *** prot., datë 10.05.2023, konfirmon transaksione financiare në emër të familjarëve të subjektit që i përkasin periudhës 2019 - 2023, konkretisht Xhoardo Lleshaj ka në hyrje 3 transaksione (EUR) me vlerë 800 euro dhe 4 transaksione (ALL) me vlerë 119.250 lekë, si dhe në dalje 3 transaksione me vlerë 1.760 euro; Leonora Lleshaj ka në hyrje 1 transaksion (EUR) me vlerë 100 euro dhe 1 transaksion (ALL) me vlerë 30.932 lekë, si dhe në dalje 2 transaksione me vlerë 234 euro; Pamela Lleshaj ka në hyrje 1 transaksion (EUR) me vlerë 500 euro.

75. Easy Pay, me shkresën nr. *** prot., datë 12.05.2023, konfirmon transaksione financiare në emër të Xhoardo Lleshaj, ku rezultojnë në hyrje 4 transaksione (EUR) me vlerë 300 euro dhe në dalje 1 transaksion me vlerë 810 euro.

75.1 Në proces - verbalin e mbajtur në datë 27.07.2023, subjekti është pyetur për transaksionet financiare të kryera dhe përfituara pranë Unionit Financiar, AK Invest dhe Easy Pay.

Subjekti sqaroi se: “...shumica e transaksioneve të kryera nga familjarët e tij, janë vlera të cilat janë dhënë nga vjehri, (babai i bashkëshortes) në pamundësi për shkak të pleqërisë për ti dërguar vetë jashtë vendit, drejtë djalit të tij dhe anasjelltas. Pjesa tjetër janë marrëdhënie familjare dhe shoqërore me djalin. Konkretisht, A. K, A. T dhe E. M. janë lidhje shoqërore e djalit Xhoardo Lleshaj. Nuk kanë për bazë fitimin apo ndikimin, por dhurata modeste në raste festash, ditëlindjesh, blerje veshje dhe ilaçe...”.

✓ **Subjekti ka dhënë shpjegime lidhur me konfirmimin e institucioneve financiare.**

77. ASHK Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon tre praktika vetdeklarimi legalizimi me nr. 8019, nr. 9522 dhe nr. 51, në emër të Fatmir Preng Lleshaj, ndodhur ne qytetin e Durrësit.

77.1 Subjekti i vlerësimit Fatmir Lleshaj u pyet me e-mailin e datës 20.11.2023, referuar të dhënave të mësipërme ku personi që ka kryer vetdeklarimin mban gjeneralitetet e subjektit, i është kërkuar të jap shpjegime në lidhje me këtë fakt.

“...Subjekti i vlerësimit i është drejtuar ASHK Durrës dhe me përgjigjen e këtij institucioni provohet që subjekti i vlerësimit z. Fatmir Lleshaj lindur më 02.05.1971 në Prosek Mirditë me atësi Preng dhe mëmësi Marte dhe banues në Tiranë nuk disponon asnjë pasuri dhe nuk ka lidhje me asnjë lloji pasurie përveç atyre që ka deklaruar në Deklaratën e Pasurisë për Vlerësimin Kalimtar...”

Konkluzion:

77.2 Trupa e vlerësimit, pas administrimit të shkresës “Kthim përgjigje”, nr***prot, datë 24.11.2023, të DVASHK Durrës, ku rezulton se Fatmir Preng Lleshaj, i datëlindjes 02.05.1971, me nr. ID H*****R, nuk është aplikues në proces legalizimi pranë DVASHK Durrës.

✓ **Konfirmohet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e administruar.**

77.3 ASHK (online) konfirmon pasuri të paluajshme të regjistruar në emër të K. Ll dhe L. Ll, regjistruar me nr. pasurie ***, përfituar me leje legalizimi. Adresa: Ishull Lezhë.

77.4 **Në proces - verbalin e mbajtur në datë 27.07.2023**, subjekti deklaroi se praktikat e legalizimit dhe pasuria e mësipërme, ku figurojnë gjeneralitetet e Leonora Lleshaj, nuk kanë lidhje me atë personalisht dhe bashkëshorten e tij. Gjithashtu, sqaroi se në dijeninë e tij, figurojnë persona të tjerë me gjeneralitetet Fatmir Lleshaj (8 të tillë) dhe konkretisht një prej tyre me atësinë Preng, ndodhet edhe në Prosek të Mirditës.

✚ **ASHK Lezhë**, me shkresën nr. 9/26 prot. dr. 29.06.2023, nuk konfirmon pasuri të paluajshme të regjistruar ne emër te Leonora Pjetër Lleshaj.

❖ **Subjekti deklaroi nën përgjegjësinë e tij se bashkëshortja Leonora Lleshaj, nuk ka pasuri të regjistruar në emër të saj.**

Hetimi i kryer nga trupa e vlerësimit:

Referuar pasurisë të paluajshme të regjistruar në emër të K. Ll dhe L. Ll, regjistruar me nr. pasurie nr*** përfituar me leje legalizimi. Adresa: Ishull Lezhë, trupa e vlerësimit kreu verifikime ku rezulton se:

*****Gjeneralitet e përmendura në pasurinë e sipërcituar nuk i përkasin personit të lidhur me subjektin e vlerësimit. Dokumentacioni i administruar konfirmon faktin e deklaruar nga subjekti i vlerësimit.**

78 QKB, me shkresën nr. *** prot., datë 08.05.2023, konfirmon se në emër të Fatmir Lleshaj dhe personat e lidhur me të, **nuk figurojnë** të jenë pajisur me NUIS (NIPT) si persona fizik apo të zotërojnë kuota/aksione në shoqëri tregtare të regjistruara pranë regjistrit tregtar.

79 D.P.Tatimeve, me shkresën nr. V-prot., datë 11.05.2023, konfirmon se Fatmir Lleshaj dhe persona të lidhur me të, **nuk figurojnë** të regjistruar në organet tatimore për ushtrim të ndonjë aktiviteti privat.

80 Drejtoria e Përgjithshme Detare, me shkresën *** prot., date 10.05.2023, **nuk konfirmon**, mjet lundrues në pronësi të Fatmir Lleshaj dhe personave të lidhur me të.

81 **Nëpërmjet hetimit të zhvilluar kryesisht Trupa e Vlerësimit**, në zbatim të Ligjit nr.12/2018 i ndryshuar, me shkresë nr.*** prot., datë 16.10.2023, kërkoi nga Regjistri Noterial pranë Ministrisë së Drejtësisë informacion në lidhje me aktet e kryera nga subjekti i vlerësimit dhe personat e lidhur me të nga ku në kthim përgjigje nr.*** prot, datë 18.10.2023 u konstatua se: janë përpiluar aktet si më poshtë:

1. Prokurë e Posaçme, Nr. Rep. *** , Nr. Kol *** , datë 31.01.2017.

2. Kontratë – Huapërdorje, Nr. Rep.***, Nr. Kol***, datë 19.03.2015.

81.1Trupa e Vlerësimit, në shterim të faktit të dalë nga kthim-përgjigje e mësipërme ju drejtua me shkresë zyrës së notërisë A. A, ku është kryer akti e mësipërm dhe me kthim përgjigje nr.***prot, datë 17.11.2023, rezulton se figurojnë veprime juridike të tjera përveç atyre që ka deklaruar subjekti i vlerësimit, konkretisht:

- Prokurë e Posaçme, Nr. rep.***, Nr. kol *** , datë 31.01.2017, ku i përfaqësuar shtetasi A. Sh, ka caktuar si përfaqësues të posaçëm Fatmir Preng Lleshaj, duke i kaluar të gjitha target për ta përfaqësuar në lidhje me pasurinë autoveturë, marka Mercedes Benz, tipi ML 350 BLUETEC 4 MATIC, viti prodhimit 2012, me targë AA***OV.

81.2 Në kuadër të kryqëzimit të informacionit, Trupa e Vlerësimit i është drejtuar subjektit me e-mail, ku më datë 10.01.2024, subjekti ka sqaruar:

*“...Për Prokurën e Posaçme me nr. *** rep.*** kol, datë 31.01.2017, është me afat të pacaktuar e kjo për arsye sepse nëse do të me duhej ta përdorja disa here këtë automjet do të me duhej të lidhja kontratë për sa herë përdorimi dhe kjo përkthehej në kosto ekonomike për mua. Kjo periudhë ka përkuar edhe me ndërprerjen e marrëdhënieve financiare me Policinë e Shtetit...”*

Konkluzion:

1. Kjo marrëdhënie nuk ka krijuar të ardhura (marrëdhënie pasurore) për subjektin e vlerësimit;
2. Nga verifikimi i të dhënave për shtetasin A. Sh, nga verifikimet e kryera nga agjencitë ligjzbatuese, nuk kanë rezultuar të dhëna për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 35 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, që të shërbej si indicie për thellimin e mëtejshëm të Trupës së Vlerësimit, për verifikim dhe hetim në kuadër të kontrollit të figurës.

82 Trupa e Vlerësimit, në shterim të faktit të dalë nga Kontratë – Huapërdorje, nr. Rep.***, nr. Kol***, datë 19.03.2015, nga noteri M. Z, ku ka rezultuar se figurojnë veprime juridike të tjera përveç atyre që ka deklaruar subjekti i vlerësimit, konkretisht:

- Kontratë – Huapërdorje, ku shtetasi D. Gj, ka shprehur vullnetin e tij të lirë për ta dhënë në përdorim mjeteve të tij për nevoja personale dhe familjare, brenda dhe jashtë vendit për një periudhë një vjeçare shtetasit Fatmir Preng Lleshaj. Automjeti që do të përdoret nga shtetasi Fatmir Preng Lleshaj.

83 Në kuadër të kryqëzimit të informacionit, Trupa e Vlerësimit i është drejtuar subjektit me e-mail, ku në datë 10.01.2024, i cili ka deklaruar:

*“...Dua të sqaroj se në kohën kur unë kam nënshkruar Kontratë Huapërdorje, Nr. *** Rep. Nr. *** Kol, datë 19.03.2015, pavarësisht se afati i kontratës ka qenë një vit, unë e kam përdorur vetëm një rast këtë automjet për të shkuar në një udhëtim jashtë Shqipërisë, në Itali. Këtë automjet dhe këtë kontratë nuk e kam përdorur herë të tjera...”*

Konkluzion:

1. Kjo marrëdhënie nuk ka krijuar të ardhura (marrëdhënie pasurore) për subjektin e vlerësimit;
2. Nga verifikimi i të dhënave për shtetasin A. Sh, nga verifikimet e kryera nga agjencitë ligjzbatuese, nuk kanë rezultuar të dhëna për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas përcaktimeve të nenit 35 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, që të shërbej si indicie për thellimin e mëtejshëm të Trupës së Vlerësimit, për verifikim dhe hetim në kuadër të kontrollit të figurës.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER MBI VLERËSIMIN E PASURISË:

84 Trupa e Vlerësimit ka analizuar dhe verifikuar të dhënat e mbledhura nga institucionet e ndryshme në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, i ndryshuar dhe në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, bazuar në parimin e kontradiktorialitetit, u mbështet edhe në shpjegimet që dha subjekti pas dërgimit të relacionit, ku arriti në konkluzionin se subjekti i vlerësimit:

- ✓ **Ka bërë deklaram të saktë, në përputhje me Ligjin, me burimet e ligjshme financiare;**
- ✓ **Nuk ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;**
- ✓ **Nuk është kryer fshehje e pasurisë;**

- ✓ **Nuk është kryer deklarim i rremë;**
- ✓ **Subjekti nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit.**

B. KONTROLLI I FIGURËS

85. Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të punonjësit dhe i të dhënave të institucioneve, me qëllim verifikimin e vërtetësisë dhe besueshmërisë së deklarimeve, si dhe identifikimi i atyre që janë të përfshirë apo të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar, kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

86. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të figurës, mbështetet në tre elementë:

- (i) *Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në deklaratën e figurës, sipas përcaktimeve të nenit 36, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;*
- (ii) *Raportin e hollësishëm të përgatitur nga struktura përgjegjëse pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore;*
- (iii) *Verifikimin e informacioneve të ardhura nga publiku, në lidhje me aktivitetin apo veprimtarinë e punonjësit apo të personave të lidhur, në zbatim të nenit 36, pika 3, gjërmirë (ë), e Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.*

87. Subjekti i vlerësimit, z. Fatmir Preng Lleshaj, në zbatim të nenit 36, pika 2, e Ligjit nr. 12/2018 “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në datën 09.03.2023.

88. Për kontrollin e figurës Trupa e Vlerësimit administroi:

- a. Deklaratën e “Kontrollit të Figurës”.
- b. Raportin e hollësishëm të përgatitur nga Drejtoria e Analizës dhe Sigurisë së Personelit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore.

89. Në përputhje me nenin 42, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, është përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit raporti me nr.*** Prot., datë 03.10.2023, i përpiluar me përgjigjet e ardhura nga institucionet publike dhe ato ligjzbatuese, verifikuese dhe informuese, ku është konstatuar **përshtatshmëria e subjektit të vlerësimit z. Fatmir Lleshaj.**

90. Në deklaratën “Kontrolli i Figurës”, subjekti i vlerësimit ka deklaruar si vijon:

- a. Në pjesën e parë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat identifikuese.
- b. Në pjesën e dytë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për vendbanimin.
- c. Në pjesën e tretë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për arsimimin dhe kualifikimet.
- d. Në pjesën e katërt të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për punësimin.

e. Në pjesën e pestë të formularit, subjekti ka plotësuar të dhënat për sigurinë, si më poshtë:

1. Nuk është dënuar ndonjëherë me vendim gjyqësor të formës së prerë nga një autoritet gjyqësor shqiptar ose i huaj.
 2. Nuk ka qenë ndonjëherë në hetim ose gjykim nga një autoritet shqiptar ose i huaj.
 3. Nuk ka qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligj zbatuese shqiptare apo të huaja për kryerjen e një veprë penale.
 4. Ndaj tij nuk është caktuar ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale në fuqi ose jo.
 5. Nuk është lëshuar asnjëherë ndaj tij një urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e veprave penale.
 6. Ndaj tij nuk është marrë asnjëherë masë dëbimi nga një shtet i huaj.
 7. Subjekti ka deklaruar që nuk ka dijeni se ndonjë nga anëtarët e familjes së tij të jetë i përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar.
 8. Nuk ka pasur kontakte të papërshtatshme në formën e takimit, komunikimit elektronik, ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës së subjektit.
 9. Subjekti nuk është në dijeni që një nga anëtarët e familjes së tij të kenë pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.
 10. Nuk ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
 11. Nuk ka dijeni se një person i familjes, ka pranuar/shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar.
 12. Nuk i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATO-s gjatë 10 viteve të fundit.
 13. Nuk ka kërkuar azil politik në ndonjë shtet.
 14. Nuk ka patur procedime penale dhe administrative, brenda dhe jashtë vendit, sipas neneve të Ligjit për garantimin dhe integritetin e personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.
 15. Nuk ka fshehur apo keq prezantuar, falsifikuar një informacion të një rëndësie të madhe, të një natyre sigurie të veçantë apo të ketë gënjyer gjatë plotësimit të formularit të deklaratës së kontrollit të figurës.
 16. Nuk ka kryer shkelje sigurie, apo të ketë nëpërkëmbur në mënyrë të përsëritur rregullat e sigurisë së informacionit të klasifikuar, apo të ketë tentuar të kryej aktivitetet të paautorizuar në sistemet e komunikimit të informacionit të klasifikuar.
 17. Nuk ka qenë asnjëherë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Ish- Sigurimi i Shtetit para vitit 1991, sipas Ligjit nr. 45/2015 “Mbi të drejtën e informimit me dokumentet e ish-shërbimit të sigurimit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
 18. Nuk ka vuajtur nga çrregullime mendore kronike.
 19. Nuk është përdorues i lëndëve narkotike.
 20. Nuk ka pasur asnjëherë varësi ndaj alkoolit apo lojërave të fatit.
- 91.** Po ashtu, subjekti ka nëshkruar edhe dy vetëdeklarimet për vërtetësinë e të dhënave dhe saktësinë e tyre të paraqitura në deklaratën e kontrollit të figurës si dhe deklaratën për dhënien

e pëlqimit për mbledhjen e të dhënave, kryerjen e kontrollit të figurës dhe aksesin për njohjen dhe administrimin e të dhënave personale.

HETIMI ADMINISTRATIV

92. Për të vijuar me kontrollin tërësor të figurës dhe saktësinë e deklaramit të subjektit të vlerësimit lidhur me këtë aspekt, në bazë të nenit 36, të Ligjit nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, janë kryer veprimet duke kërkuar të dhëna nga institucionet agjencitë ligjzbatuese, ku ka rezultuar si vijon:

93. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën “E paklasifikuar”, Nr. ***.Prot, datë 12.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, bën me dije se:

- Nuk ka ndryshim të gjeneraliteteve të subjektit të vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj.

- ❖ Vetë subjekti i vlerësimit Fatmir Lleshaj ka deklaruar në formular se, “*Mbiemri Lleshi, e ndryshuar nga zyra e gjendjes civile Mirditë për të gjithë mbajtësit e këtij mbiemri, nga mbiemri “Lleshi” në mbiemrin “Lleshaj”.*”

- ✚ Trupa e Vlerësimit, pas verifikimeve të kryera sipas Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, konfirmon se deklarimi i subjektit të vlerësimit është i sakt.

94. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.***.Prot, datë 19.5.2023, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.***.Prot, datë 29.12.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, si dhe personat e lidhur me të, bën me dije se:

- Nuk rezultojnë të dënuar.

95. Institucion ligjzbatues, me shkresën “Sekret”, Nr.***.Prot, datë 25.05.2023, me shkresën “Sekret”, Nr.***Prot, datë 04.01.2024 dhe me shkresën “Sekret”, Nr.***Prot, datë 30.01.2024, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, si dhe personat e lidhur me të, bën me dije se:

- Për subjektin e vlerësimit z. **Fatmir Preng Lleshaj**, rezulton se në ngarkim të tij janë administruar informacione/të dhëna, të cilat janë ndarë me institucionet ligjzbatuese, të cilat pas verifikimeve të kryera ka rezultuar se këto informacione/të dhëna, nuk janë të konfirmuara sipas përcaktimeve të neneve 35 – 42 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar. Ndërsa për personat e lidhur sipas certifikatës familjare, nuk janë administruar informacione.

96. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. ***.Prot, datë 30.05.2023, me shkresën “E Paklasifikuar”, Nr. ***Prot., datë 30.05.2023, me shkresën “Sekret”, Nr. ***.Prot, datë 20.12.2023, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. ***.Prot, datë 11.01.2024 për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, si dhe personat e lidhur me të:

- **Nuk kanë** të dhëna apo indicie për fillimin e hetimeve në lidhje me dyshimet e ngritura në kuptimin penal dhe të cënimit të figurës së subjektit, të përfshirë drejtpërdrejt ose indirekt në veprime të dyshimta;
- **Nuk kanë** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në *krimin e organizuar*, (sipas përcaktimeve të bëra në ligjin Nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”) ku mund të përfshihen biseda, foto vëzhgime takimesh apo kontakte telefonike, etj;
- **Nuk kanë** të dhëna për kontakte të papërshtatshme me persona (*persona të dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të Ligjit nr. 10 192, datë 03.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar*);
- **Nuk kanë** të dhëna në lidhje me hetimin ose gjykimin nga një autoritet shqiptar ose i huaj, për kryerjen e një vepre penale;
- **Nuk kanë** të dhëna në lidhje nëse ka qenë i ndaluar apo i arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare apo të huaja, për kryerjen e një vepre penale;
- **Nuk kanë** të dhëna në lidhje me lëshimin e ndonjë urdhëri ndërkombëtar, për kryerjen e një vepre penale;
- **Nuk kanë** të dhëna në lidhje me ndonjë masë dëbimi nga një shtet i huaj;
- **Nuk kanë** të dhëna në lidhje nëse gjatë 10 viteve i është refuzuar hyrja në ndonjë shtet të BE/NATOS-s;
- **Nuk kanë** të dhëna nëse nga subjekti është kërkuar azil politik në ndonjë shtet.

97. Institucion ligjzbatues, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.***.Prot, datë 31.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, bën me dije se:

- **Nuk** disponon të dhëna.

98. Avokati i Popullit, me shkresën “E Paklasifikuar”, Nr. 268/1.Prot, datë 30.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, bën me dije se:

“...Me rekomandimin e datës 01.04.2002, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për dijeni Ministrin të Brendshëm, Avokati i Popullit ka rekomanduar dhënien e masës disiplinore të pezullimit nga detyra të oficerëve të policisë Fatmir Lleshaj dhe V. F. Ky rekomandim ka lidhje me verifikimet e kryera, në lidhje me ankesën e shtetasve K. C, L. C dhe A. C, të cilët kanë pretenduar për veprime arbitrare ushtruar ndaj tyre nga punonjësit e policisë Fatmir Lleshaj dhe V. F...”

99. Institucion ligjzbatues, me shkresën “Sekret”, Nr. ***Prot., datë 13.06.2023, dhe shkresën “Sekret”, e datës 19.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, bën me dije se:

1. Në lidhje me rekomandimin e Avokatit të Popullit, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, ku është regjistruar procedimin penal nr. 290 viti 2002, në ngarkim të Fatmir Lleshi dhe V. F për veprat penale të parashikuar nga neni nr. 70/1 të Kodit Ushtarak Penal dhe neni 89 të Kodit Penal.

Në përfundim të veprimeve hetimore Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur **pushimin** e hetimeve që kanë lidhje me procedim penal nr. 290/2002, me arsyetimin ligjor se, *në rastin konkret nuk vërtetohet që shtetasit Fatmir Lleshaj dhe V. F të kenë kryer veprime që bien ndesh me ligjin apo me përmbushjen e detyrës, nga ana e tyre.*

2. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 3340 viti 2015, për veprën penale “*kallëzimi i rremë*”, inicuar me kallëzimin e shtetasit O. D, dërguar në prokurori në rrugë postare, me të cilin kërkohej ushtrimi i ndjekjes penale ndaj shtetasit Fatmir Lleshaj dhe E. P, të dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Shpërdorimi i detyrës*” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, pasi sipas kallëzuesit, kanë ushtruar dhunë fizike ndaj tij brenda ambjenteve të Komisarariatit të Policisë Nr. 5 Tiranë.

Nga verifikimet e kryera në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me shkresën nr.***, datë 27.06.2023, bën me dije se, “*pas verifikimeve të kryera në indeksin e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për periudhën kohore vitet 1990-2023, rezultoi se në vitin 2015, për shtetasin Fatmir Preng Lleshaj, është administruar një kallëzim nga shtetasi O. D. Në kuadër të verifikimeve Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar procedimi penal nr. 3340 viti 2015, për veprën penale “Kallëzim i rremë” (në ngarkim të kallëzuesit). Prokurori i çështjes ka marrë vendim për pushim të hetimeve më datë 07.07.2015, si dhe procedimi penal nr. 3340/1, viti 2015 për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, për të cilin më datë 10.07.2015 është vendosur pezullimi i hetimeve.*

 **Hetimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit:**

Trupa e Vlerësimit, në lidhje me *procedimin penal nr. 3340/1, datë 10.07.2015*, ka kryer verifikime pranë Drejtorisë Rajonale të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, e cila me shkresën nr.***Prot., datë 23.01.2024, ka informuar se, “...nga verifikimet e kryera, mbi bazën e detyrave të planifikuara, me qëllim identifikimin e autorit të ngjarjes, nga koha e marrjes në ndjekje të këtij procedimi penal, rezulton se ndaj punonjësit të policisë Fatmir Preng Lleshaj, nuk janë administruar të dhëna të reja që e implikojnë atë në kryerjen e veprës penale për të cilën është regjistruar ky procedim penal. Dosja e Fashikullit të Procedimit Penal Nr. 3340/1 i vitit 2015, ndodhet **e arkivuar** në Sektorin e Kartotekës të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore...”.

100.Institucion ligjbatues, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.***.Prot, datë 10.07.2023, me shkresën “I Kufizuar”, Nr.***.Prot, datë 07.02.2024, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, bën me dije se:

- **Nuk** është nxjerrë urdhër ndalimi;
- **Nuk** është kërkuar masë e sigurimit personal dhe nëse po, vlerësimi i tyre nga gjykata;
- **Nuk** është marrë në cilësinë e të pandehurit apo personit nën hetim sipas përcaktimeve të nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale;
- **Nuk** ka pasur raste të urdhrave ndërkombëtar të ndalimit.
- Drejtoria e Koordinimit Institucional në Prokurorinë e Përgjithshme, me shkresën nr.***Prot, datë 27.06.2023, bën me dije se: Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka rezultuar se“...nga verifikimi i kryer në indekset e kallëzimeve dhe statistikave të procedimeve penale për periudhën kohore vitet 1990-2023 rezultoi që në ngarkim të Fatmir Preng Lleshaj, i datëlindjes 02.05.1971, të jetë rregjistruar procedimi penal nr. 3340 viti 2015, për veprën penale “Kallëzimi i rremë” parashikuar nga neni 305 i Kodit Penal, marrë vendim për **pushim** të hetimeve më datë 07.07.2015. Bashkëlidhur kopje të njehsuar me origjinalin, të vendimit të pushimit...”. **Trajtuar më sipër.**

101.Institucion ligjbatues, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. ***.Prot, datë 07.06.2023, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. ***.Prot, datë 27.12.2023, dhe me shkresën “I Kufizuar”, Nr. ***.Prot, datë 28.12.2023, bën me dije se për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, si dhe personat e lidhur dhe persona të tjerë të lidhur me subjektin:

- **Nuk** rezulton të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

102.Institucion ligjbatues, me shkresën “Sekret”, Nr. ***.Prot, datë 25.05.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, dhe personat e lidhur me të sipas certifikatës familjare, bën me dije se:

- **Nuk** rezultuan raportime për subjektin e vlerësimit Fatmir Lleshaj,
- **Nuk** rezultuan raportime për personat e lidhur Leonora Lleshaj, Pamela Lleshaj dhe Xhoardo Lleshaj.

103.Institucion ligjbatues, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. ***.Prot, datë 25.05.2023, me shkresën “I Kufizuar”, Nr***Prot, 28.12.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, bën me dije se:

- Është i pajisur me Certifikatë Sigurie Personeli (CSP), nivelin “Tepër Sekret” lëshuar më datë 23.05.2022, e vlefshme deri më datë 22.05.2027. Nuk është marrë vendim për refuzim, heqje apo pezullim të përkohshëm të CSP.
- Nuk disponohen rekorde për shkelje sigurie në lidhje me informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror”, të NATO, BE, shteteve dhe organizatave të tjera ndërkombëtare.

104.Institucion ligjbatues, me shkresën “I Kufizuar”, Nr. ***.Prot, datë 08.06.2023, për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, bën me dije se:

- Nuk ka qenë në ndjekje për spiunazh, terrorrizëm si dhe anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga ish-Sigurimi i Shtetit deri 2 Korrik 1991.

105.Denoncime nga publiku

Për subjektin e vlerësimit z. Fatmir Preng Lleshaj, **nuk është disponuar asnjë ankese** nëpërmjet portalit të Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore për denoncime nga publiku për subjektet e vlerësimit kalimtar dhe periodik.

106.Testi për përdorim lëndësh narkotike:

Subjekti i vlerësimit në zbatim të pikës 2, të nenit 38, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, ka kryer testin mbi përdorimin ose jo të lëndëve narkotike. Në bazë të rezultateve të përfituara testimi për përdorim lëndësh narkotike, konkludohet se **nuk u zbulua** prania e substancave të testuara.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER PËR KONTROLLIN E FIGURËS:

Trupa e vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pas një hetimi të thelluar të kontrollit të figurës për subjektin e vlerësimit Fatmir Lleshaj, nëpërmjet analizimit dhe verifikimit të të dhënave të deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, analizimit dhe verifikimit të të dhënave të mbledhura nga institucionet dhe agjencitë ligjbatuese, vlerësimit të testit për përdorim lëndësh narkotike, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera,

në përputhje me Ligjin nr. 12/2018, “Për Vlerësimin Kalimtar dhe Periodik të Punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” i ndryshuar, arriti në konkluzionin se:

- ✓ Subjekti i vlerësimit z. Fatmir Lleshaj, ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.
- ✓ Nuk ka informacion në deklaramin e tij ose nga institucionet përgjegjëse të përcaktuara në këtë ligj që tregojnë se punonjësi ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar për përfshirje në krimin e organizuar.

C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

107. Objekt i vlerësimit të aftësive profesionale është vlerësimi i nivelit të arsimimit dhe trajnimit në përputhje me gradën dhe/ose pozicionin e subjektit të vlerësimit, respektimi i rregullave të etikës dhe i përmbushjes së detyrave nga subjekti, në përputhje me nenet 43, 44, 45 dhe 47, të Ligjit 12/2018, i ndryshuar, si dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e punonjësit të Policisë së Shtetit.

108. Analiza ligjore e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale mbështetet në dy elemente:

- a. Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar;
- b. Raportin e përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit sipas përcaktimeve të nenit 46, pika 2, Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.

109. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në përputhje me nenin 46 pika 2, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka përcjellë pranë Trupës së Vlerësimit, për subjektin e vlerësimit Fatmir Lleshaj, raportin e vlerësimit të aftësive profesionale me Nr. *** Prot., datë 05.07.2023, të përpiluar në mënyrë të hollësishme dhe të arsyetuar, në të cilin është konstatuar se:

Punonjësi i Policisë, Fatmir Lleshaj, është i përshtatshëm për pozicionin e tij të punës, ka arsimin dhe trajnimet përkatëse për funksionin që mban, ka treguar cilësi të pranueshme në punë, aftësi në zbatim të detyrave sipas përshkrimeve të punës, ka respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, është i frytshëm dhe efektiv në masë të pranueshme, duke rezultuar i kualifikuar për të ushtruar funksionin që mban.

HETIMI ADMINISTRATIV

110. Subjekti i vlerësimit, Fatmir Lleshaj, në momentin e dorëzimit të dokumentacionit në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka ushtruar funksionin e Drejtorit, në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Drejtimit në Departamentin e Sigurisë Publike, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

111.Në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, ku përcaktohet se periudha e vlerësimit për aftësitë profesionale, për efekt të këtij Ligji, përfshin periudhën që nga data e emërimit të punonjësit në gradën/pozicionin që mban, jo më shume së 5 (pesë) vjet.

112.Subjekti i vlerësimit Fatmir Preng Lleshaj, me Urdhër Nr. 864, datë 27.4.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, është liruar nga detyra dhe është vënë në dispozicion të Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Me Urdhër Nr. 1704, datë 16.12.2020, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për nevoja punë është transferuar dhe emëruar në detyrën e Drejtorit, në Drejtorinë e Menaxhimit dhe Drejtimit, në Departamentin për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Trupa e Vlerësimit, në zbatim të nenit 44, pika 2 për Vlerësimin e Aftësive Profesionale, të subjektit të vlerësimit do të filloj procedurën e vlerësimit nga viti 2020 deri në datë 09.03.2023, për arsye se subjekti i vlerësimit nga viti 2017 deri në dhjetor 2020, ka qenë në dispozicion të strukturave të Policisë së Shtetit.

113. Vlerësimi i aftësive profesionale mbështetet në:

- Të dhënat e administruara në dosjen personale të subjektit me nr. ***.
- Të dhënat e administruara në sistemin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore Sistemi RMIS, me numër ***.
- Të dhënat e deklaruara nga subjekti i vlerësimit në formularin e aftësive profesionale, sipas përcaktimeve të nenit 44, pika 1, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, të mbështetura në dokumentacionin shoqërues të dorëzuar nga vetë subjekti.
- Të dhënat e siguruara nga Drejtoria e Standardeve Profesionale mbi Performancën e subjektit.

114. Të dhënat e siguruara nëpërmjet burimeve të mësipërme, konfirmojnë nivelin e arsimor, ecurinë në karrierë dhe gradë, trajnimet, kualifikimet, vlerësimet individuale të punës si dhe Performacës e konstatuar gjatë kontrolleve, inspektimeve apo ankesave në drejtim të subjektit nga Drejtoria e Standardeve Profesionale apo institucioneve të tjera mbikëqyrëse.

Në Formularin e Aftësive Profesionale subjekti deklaron:

115.Të dhëna për Arsimimin:

- Arsim i Lartë - Akademia e Forcave Tokësore, viti 1990-1994.

116.Sipas të dhënave të administruara në Dosjen Personale të subjektit, rezulton së subjekti ka përfunduar arsimin e lartë. Në kuptim të Ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar, pas verifikimit dhe vlerësimit të dokumentacionit të administruar, rezulton se:

- ✓ Subjekti përmbush kriterin e nivelit arsimor për funksionin që ushtron pranë Policisë së Shtetit, në momentin e dorëzimit të deklaratës së vlerësimit të aftësive profesionale.

Certifikatat e trajnimeve, kualifikimeve dhe medaljet

117. Sipas të dhënave të administruara në dosjen personale të subjektit, të përcjella me raportin e vlerësimit të aftësive profesionale, rezulton se ai ka kryer trajnimet dhe specializimet, si më poshtë vijon:

Nr.	Viti	Emërtimi i trajnimit	Lloji i dokumentit
1	1998	Kursi Bazë tre-mujor në qendrën e trajnimit të Misionit M.A.P.E	-----
2	2000	Trajnim të policëve super vizorë	Çertifikatë
3	2011	Trajnim 1- javor I.L.E.A Budapest/Hungari	Çertifikatë
4	2014	Shërbimet që ofron Policia e Shtetit në zyrat e shërbimit të qytetarit	Çertifikatë
5		Akademia e Sigurisë/ICITAP/Trajnim dy-javor	Çertifikatë

Krahas specializimeve/certifikatave të përmendura më sipër, subjekti ka deklaruar në Formularin e aftësive profesionale edhe një sërë trajnimesh/specializimesh të kryera brenda dhe jashtë vendit, gjatë gjithë karrierës së tij, (bashkëlidhur certifikatat) të cilat kanë shërbyer në formimin profesional të tij.

✚ Nga verifikimi i të dhënave të administruara, rezulton se:

Trupa e Vlerësimit pas administrimit të dosjes së personelit, raportit të vlerësimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur, konstatoj se gjatë periudhës 2020 – mars 2023, të vlerësimit në zbatim të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

1. Nuk ka realizuar asnjë trajnim;
2. Nuk ka asnjë kualifikim;
3. Nuk ka marrë asnjë certifikatë për performancë të lartë në realizimin e detyrave.

Trupa e vlerësimit vë në dukje faktin se, dokumentacioni bashkëlidhur raportit të vlerësimit, përmban certifikata trajnimesh për subjektin e vlerësimit të një periudhë relativisht të hershme, për harkun kohor të sipër cituar mësipër. Në përputhje me dispozitat e ligjit të vlerësimit, kjo periudhë nuk është objekt vlerësimi dhe për këtë arsye këto kualifikime nuk do të trajtohen në kuadrin e kualifikimeve të përfituara nga subjekti i vlerësimit për periudhën (dhjetor 2020 – mars 2023)

- ✓ **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**
- ✓ **Subjekti ka kryer trajnime/specializime të shumta në përputhje me funksionin që ushtron (përpara periudhës së vlerësimit).**

118.Vlerësimet e punës

118.1 Nga dokumentacioni i dorëzuar pranë Trupës së Vlerësimit, për periudhën 2020 – mars 2023, nga ku janë administruar 3 (tre) vlerësime të aftësive individuale të punës si dhe bazuar në sistemin e vlerësimit dhe pikëzimit të rezultateve të punës për performancën vjetore, rezulton se subjekti është vlerësuar në të katër vitet me pikët maksimale për punën e kryer, si më poshtë vijon:

Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2020 - 31/12/2020	28 pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2021 - 31/12/2021	27 pikë	(shumë mirë)
Vlerësimi i rezultateve të punës për periudhën 01/01/2022 - 31/12/2022	94 pikë	(shumë mirë)

118.2 Në vlerësimet e mësipërme vlen të theksojmë së në periudhën 2020- 2021 vlerësimi maksimal i punonjësve sipas formularit të vlerësimit ishte me 28 pikë, ndërkohë nga viti 2022 e në vazhdim vlerësimi maksimal është 100 pikë.

118.3 Vlerësimi i aftësive individuale të punës sipas standardeve të përcaktuara bëhet nga eprori i drejtpërdrejtë, bazuar në vlerësimin e integritetit, profesionalizmit, komunikimit, qëndrimit konstruktiv, paanshmërisë, punës në grup si dhe planifikimit dhe organizimit të punës.

118.4 Bazuar në vlerësimet e mësipërme të administruara nga Trupa e Vlerësimit, konkludohet:

- ✓ **Deklarimi i subjektit të vlerësimit është i saktë.**
- ✓ **Subjekti ka përmbushur detyrat profesionale, ka respektuar rregullat e etikës, si edhe ka shfaqur performancë të lartë funksionale.**

119.Masat disiplinore

119.1 Referuar raportit të dërguar nga DPPSH ku konfirmon se ka verifikuar dokumentacionin në dosjen personale të subjektit, si dhe nga verifikimi i Trupës së Vlerësimit në sistemin RMIS, rezulton së gjatë periudhës 2020 - 2022 të përcaktuar në pikën 2, të nenit 44, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, subjekti i vlerësimit:

✓ Nuk është ndëshkuar me masë disiplinore.

✓ Deklarimi i subjekti është i saktë.

120.Ecuria në karrierë

Subjekti i vlerësimit, Fatmir Lleshaj, ka një karrierë në Policinë e Shtetit prej 22 e 5 muaj.

Nga verifikimi i kryer nga Trupa e Vlerësimit rezulton se gjatë periudhës 2020 - 2022 vjeçare, subjekti Fatmir Lleshaj, ka ecurinë në karrierë, si vijon:

Data e fillimit		Data e përfundimit		Institucioni	Funksioni	Emër mbiemer i Punëshënësit apo eprori i drejtpërdrejtë	Adresa e plotë e institucionit	Arsyeja e largimit
Muaj	Viti	Muaj	Viti					
17.12.2020		Aktualisht		DPPSH	Drejtori i Menaxhimit dhe Drejtimit	Rebani Jaupi	Bulevardi "Bajram Curri", Nr. 3 Tiranë	
27.4.2017		1.12.2019		Policia e Shtetit	Dizpozicion/i papunë	Ardi Veliu Haki Çako	Bulevardi "Bajram Curri", Nr. 3 Tiranë	Transferuar për nevoja pune
16.6.2016		27.4.2017		D.V.P Berat	Drejtor	Haki Çako	Berat	Transferuar për nevoja pune

121.Në lidhje me përputhshmërinë e gradës me funksionin/pozicionin e punë, subjekti i vlerësimit ka përfituar gradat si me poshtë:

Emërtimi i gradës	Arsyeja e ndryshimit	Nr. Urdhëri	Data	
			Nga	Deri
Komisar	Ripranuar në polici me vendim gjykate	Nr. 3187, datë 15.10.2010	18.10.2010	25.12.2014
Kryekomisar	Ricertifikuar për gradë policore	Nr. 3807, datë 29.12.2014	26.12.2014	13.3.2017
Drejtues i Parë	Dhënë grada me vendim gjyqësor	Nr. 413, datë 13.3.2017	14.3.2017	

120.1 Në përfundim, në lidhje me ecurinë në gradë dhe në karrierë të z. Fatmir Lleshaj, bazuar në deklaratimet e bëra, verifikimet nga dokumentacioni i administruar, Trupa e Vlerësimit konkludon se **funksionet në të cilat është emëruar subjekti, si dhe gradat që ai ka përfituar gjatë karrierës, janë në përputhje dhe në zbatim me legjislacionin rregullator të kohës, ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.**

122.Pjesëmarrja në konferenca shkencore, workshop-e, seminare, botime brenda dhe jashtë vendit

122.1 Subjekti i vlerësimit, z. Fatmir Lleshajj, për periudhën e përcaktuar në formularin e aftësive profesionale, nuk ka marr pjesë në ndonjë konferencë, workshop, seminar apo botim brenda dhe jashtë vendit.

NË PËRFUNDIM TË HETIMIT TË KRYER

123.Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi kreu një hetim të thelluar për vlerësimin e aftësive profesionale, nëpërmjet verifikimit të dosjes personale të subjektit të vlerësimit, verifikimit të nivelit arsimor të subjektit të vlerësimit, vlerësimin e përmbushjes së detyrave funksionale dhe respektimin e rregullave të etikës në ushtrimin e detyrës si punonjës në Policinë e Shtetit, arrin në konkluzionin se, subjekti i vlerësimit Fatmir Lleshaj:

- ✓ *Është i përshtatshëm duke patur arsimin/trajnimin përkatës për funksionin;*
- ✓ *Ka rezultuar i kualifikuar për ta ushtruar atë funksion që mban;*
- ✓ *Ka vlerësime pozitive pune.*

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të vlerësimit, relacionin e relatores së çështjes, shpjegimet me shkrim të dhëna nga subjekti i vlerësimit gjatë hetimit administrativ, si dhe pasi u njoh me qëndrimin e subjektit të vlerësimit në seancën dëgjimore publike të datës 28.02.2024, ftoi subjektin në seancën e dhënies së vendimit të datës 05.04.2024, arrin në konkluzionin se subjekti i vlerësimit, z. Fatmir Preng Lleshaj, në përputhje me nenin 60 të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e pasurisë;*
- *Konstatohet nivel i besueshëm në vlerësimin e kontrollit të figurës;*
- *Konstatohet nivel i mjaftueshëm në vlerësimin e aftësive profesionale.*

PËR KËTO ARSYE:

Trupa e Vlerësimit pranë Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, bazuar në pikën 7, të nenit 56, të

Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në bazë të gërmës “a”, të nenit 59, si dhe të pikës 1 dhe 2 të nenit 60, të Ligjit nr. 12/2018, të ndryshuar;

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të vlerësimit, **z. Fatmir Preng Lleshaj**, me funksion Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit dhe Drejtimit, në Departamentin e Sigurisë Publike, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim i njoftohet subjektit të vlerësimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e shpalljes së vendimit.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Agjencisë Mbikëqyrjes Policore në përputhje me pikën 8, të nenit 56, të Ligjit nr. 12/2018, i ndryshuar.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 45 ditëve nga data e njoftimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 05.04.2024.

TRUPA E VLERËSIMIT

Klevis DHIGOI
Kryesues

Erjana PJETRI
Relatore

Ersa KARAJ
Anëtare